


Ja si bien në grackë gazetarët në Tiranë nga fake news të bëra në Maqedoni

“Rusët po blejnë media në Shqipëri”, autori i shkrimit të supozuar Mark Gjonaj dhe zbulon të vërtetën e lajmit të rremë

NGA KLAUDJA KARABOLLI & ANTONIO ÇAKSHIRI

▶ FAQE 10-11



Edhe 30 sekonda janë tepër për ata që na duan

Kur Shqipëria të gjejë vërtetë rrugën e stabilitetit dhe kur rrugëtimi drejt përmirësimit dhe civilizimit të kryhet natyrshëm e pa energjinë negative si pengesë, vlen një reflektim: Sa shumë energji e vëmendje harxhojmë për armiqtë dhe sa pak ose aspak për miqtë.

vijon në faqen 16

[SHQIPTARJA.com]

ÇMIMI 30 LEKË

VITI VII - NR.140

E SHTUNË, 17-06-2017

www.shqiptarja.com



PADIA NDAJ "SHQIPTARJA.com" DONALD LU TAKON GAZETARET E PADITUR NGA GJYQTARI GJIN GJONI

Mbështetja nga SHBA, ambasadori: Beteja juaj është beteja jonë

▶ F9



INTERVISTA NE REPORT TV Shkëlzen Maliqi: 90 për qind Kurti kryeministër i Kosovës

Analisti shprehet se LDK është më e prirur t'i bashkohet Vetëvendosjes për të krijuar qeverinë e re

▶ F17

NGA ESENKA MELEQI

SOT VOTIMI

▶ F8

NIS VETINGU, 800 GJYQTARE DHE PROKURORE NEN HETIM

Seancë të jashtëzakonshme për miratimin e anëtarëve, kontrolli nis me dosjet e pasurive



Presidenca

A MUND TE SHKARKOHET ILIR META NGA KUVENDI?

Skenarët e ikjes së kreu të ri të shtetit, nga shkarkimi tek dorëheqja. Vetë Meta paralajmëron: Nëse Vasili bëhet kryeministër, dorëhiqem si president

▶ FAQE 3

FUSHATA ELEKTORALE NE SARANDE

▶ FAQE 4

DEGJENERON FUSHATA, KANDIDATI I PS KERKON VOTA NE ZYRAT E PD DHE LSI

Incidenti me Alket Hysenin denoncohet nga ministri i LSI Dervishaj: Provokoi vajzën e LRI duke e ftuar në zyrën e Rilindjes



Tahiri: LSI është një kalë që po ngordh, do dalë në opozitë

Nga Kuçova, kryeministri Rama u bëri dje thirrje policëve dhe mësuesve që pas orarit të punës të kërkojnë votat për PS për të vazhduar reformat dhe jo të kthehen në kohën e Saliut. "U bëj thirrje mësuesve të gjithë Kuçovës dhe gjithë Shqipërisë të mos lenë minutë, ditë e natë pa shfrytëzuar që dinjteti i tyre i vënë në vend të cenohet përsëri. I bëj thirrje të gjithë punonjësve të Policisë së Shtetit, në momentin që lënë uniformën, pas punës të përkushtohen për të marrë sa më shumë vota për PS-në, në mënyrë që të mos lejojmë rikthimin e hijes së turpiti mbi uniformën e tyre", tha Rama. Kjo deklaratë ka shkaktuar reagimin e fortë të LSI-së. Rama kërkoi votën e qytetarëve për të qeverisur të vetëm me mandat të plotë në mënyrë që të mos shantazhohen në rrugën e ndërtimit të shtetit.

"Na jepni votën për të qenë të pa shantazhueshëm nga partitë e tjera, që marrin votuan tuaj dhe duan të fusin dorën në tepsin", tha ai. Kryeministri Edi Rama ka vijuar fushatën elektorale në qytetin e Beratit, ku tha se nuk ka asnjë luftë politike me forcat e tjera, pasi në 25 qershor nuk do vendoset kush qeverisë Shqipërinë, por si do jetë Shqipëria e gjeneratës tjetër. Rama tha se do bëjë 5-fishin e punës nëse qytetarët i japin 5 mandate në Berat. "Nuk ka luftë me forcat e tjera politike. Administrata do jetë shërbëtorja juaj. Në 25 qershor nuk vendoset kush do qeverisë Shqipërinë, por si do jetë Shqipëria e gjeneratës tjetër. Do vendoset nëse këtë flamur do ta ngremë në ambicien e atyre që dhanë jetën për të. Apo do ndahemi në tufa-tufa të partive që dinë të premtojnë dhe vetëm copëtojnë Shqipërinë dhe atyre që i votojnë. Po të doja pushtet për vete, Luli nuk do ishte sot në Berat duke folur si një punonjës social, por do ishte në çadër dhe do priste të vinte nata të freskoj. Ju bëj thirrje të gjithëve, partitë mbajni në zemër, por votoni me mendje. Kur të shkoni në kutitë e parive, por mendoni për fëmijët tuaj që duan të ecin drejt përpara. Mos mendoni se çdo ndodhë me partitë e pushtetit, por jepini një dorë fuqizimit të shtetit. Do bëjmë 5-fishin e punës nëse na jepni 5 mandate"-tha Rama.

MALIQI

Pas largimit nga lista e PD në qarkun e Beratit, Lefter Maliqi sot ka marrë pjesë në mitingun e PS në Lapardha, ku ishte i pranishëm edhe kryeministri Edi Rama. Ai hapi fushatën dhe shprehu bindjen duke siguruar Ramën se PS do të marrë 5 mandate në këtë qark dhe 76 në rang kombëtar në 25 qershor për të formuar e majta e vetme qeverinë. "Dua t'i siguroj

"Nëse bëni pazar dhe nuk votoni PS-në, katër vitet e ardhshme duhet të heshtim"

Partia Socialiste vijon goditjet ndaj LSI-së duke ju thënë njerëzve se LSI do të jetë në opozitë pas 25 qershorit. Gjatë një takimi elektorale në Pezë, kreu i PS-së së Tiranës, Saimir Tahiri deklaroi se votat e shqiptarëve në 25 qershor

nuk mund të shkojnë për një parti që do të dalë në opozitë, por për PS-në e cila do të qeverisë së bashku me qytetarët. Tahiri u kërkoi qytetarëve të mos hedhin votë në parti si LSI. "Po mirë kush nga ju që ka pesë lekë në shtëpi, dhe me ato pesë lekë do të blinte një kalë që është duke ngordhur? Kush nga ju që ka pesë lekë në shtëpi shkon dhe ble një shtëpi që është duke rënë? Kush nga ju që ka pesë lekë shkon dhe investon në një tokë që nuk nxjerr prodhim? Kush nga ju që ka pesë lekë në shtëpi investon në një biznes që nuk fiton? Po kur vota është investimi më i madh për katër vitet e ardhshme, tek një parti që ti pret të zgjidhe hallet e tua, për cilën arsye do e votosh, do e çosh votën tënde, këtë lloj investimi tëndin tek LSI-



ja? LSI-ja miqtë e mi pas 25 qershorit do të jetë në opozitë. Dhe në qeverisje do jetë Partia Socialiste, Edi Rama dhe ju. Vetëm kaq. Asnjë tjetër", tha Saimir Tahiri. Hedhja e votës për partinë që sipas tij u zgjidh problemet nesër, ka

qenë mesazhi i drejtpërdrejtë që Tahiri u përcollti banorëve të Pezës. "Në qoftë se ti ke hallin të jesh më i fortë, të kesh një shtet që të mbron, të kesh drejtësi, ata duan gjyqtarët e korruptuar, shtetin e duan të rrënuar, sepse vetëm ashtu mund të rrinë në këmbë, e vetëm ashtu mund t'u rrinë kalaqafe njerëzve. Po ne nuk kemi dot hallet e tyre dhe as qajmë hallet e tyre. Ne në datë 25 qershor nuk do të merremi me hallet e tyre. Në datë 25 është dita e vetme kur ju mund të vendosni për hallet e tuaja. Përndryshe në qoftë se e bëjmë pazar, duhet të heshtim për katër vitet e ardhshme miqtë e mi. Në qoftë se e bëjmë pazar dhe nuk çojmë tek kutia e votimit këdo që s'ka votuar dot deri dje Partinë Socialiste, duhet të heshtim", -u shpreh Tahiri.



Edi Rama: Policë dhe mësues mblidhni sa më shumë vota për PS-në

Thirrja e kryeministrit në Berat: Nëse na jepni 5 mandate do bëjmë 5-fishin e punës

kryeministrit Edi Rama një fitore të thellë. Të majtë e të djathtë bashkë për të votuar numrin 2, për një fitore të

thellë në qarkun e Beratit. Blendi Klosi është me fat se është i pari. Por me fat është edhe Fadil Nasufi i katërti. Ju

e dini që unë doktorët i kam qejf, dhe po ju them i pesti në listën e PS është mjeku i Beratit, Konomi. Të punojmë

fort për të marrë 5 mandate. Rama ka thënë do marrë 71 mandate, por po iu them, 5 mandate i ke në Berat, 71 i ke nga Fieri e tutje, 76 mandate për PS, mos u gënjeni, por bashkohuni për PS", -deklaroi ai. Ndërsa Rama e cilësoi si të paprecedentë, faktin që në historinë e pluralizmit një deputet nga lista e PD i është bashkuar PS. "E paprecedentë në historinë e pluralizmit, që një deputet në listën e PD-së i është bashkuar PS, jo për interesa por për të përfaqësuar me dinjtet këtë komunitet. I jam mirënjohës Lefterit që me kurajë qytetare dhe me vetëdije politike na u bashkua në këtë betejë. Në 25 qershor pavarësisht bindjes politike dhe çfarë thotë njëri apo tjetri, zgjedhja është qartë, çdo shqiptar është pjesë e trupës së madhe popullore të gjykimit për çdo skuadër, se çfarë ka bërë. Duhet të bashkohemi të gjithë në një flamur për ta dërguar në BE, votoni PS", deklaroi Rama. Lefter Maliqi u largua nga PD, pasi nuk pranoi që të jetë i treti në listën e koalicionit të opozitës së udhëhequr nga

Reagimi

Demiraj: Policia nuk merr pjesë në fushatë



Ministri i Brendshëm, Dritan Demiraj, i është përgjigjur menjëherë nënkryetarit të LSI, Luan Rama, i cili shprehu shqetësimin për përdorimin e policisë për të mbledhur vota. Në një dalje të menjëhershme për mediat, ministri paralajmëroi Policinë e Shtetit që të mos marrë pjesë në fushatë, pasi çdo punonjës rrezikon burg nga 1-5 vite burg. Ai ftoi policët që të respektojnë ligjin, pasi janë në monitorim të rreptë. "Policia e ka të ndaluar për të marrë pjesë në fushatë. Policët nuk mund të mbështesin asnjë parti, pasi përbën veper penale dhe dënohet nga 1 deri në 5 vite. Të gjithë punonjësit janë në monitorim, prandaj të respektojnë ligjin", deklaroi ai.

Lulzim Basha. Pas largimit nga PD, Lefter Maliqi lëshoi edhe disa akuza ndaj Bashës për mënyrën e drejtimit të së djathtës.

Reagimi i ashpër

LSI: Rama urdhër policisë për të vjedhur votat, të reagojë SHBA

Kryetari i grupit të LSI, Luan Rama ka reaguar ashpër pas thirrjes së Ramës për policinë e shtetit. "Qëndrim i papërgjegjshëm i Ramës, në humbje totale të logjikës ka deklaruar sot në Berat sefton policinë e shtetit, që pasi të lerë orarin e punës të mbledhë vota për PS pas orarit të punës. Ky është një rast skandaloz, provokativ, pasi policia e ka të ndaluar të marrë pjesë edhe pas orarit të punës në veprimtari politike dhe të mbledhë vota për llogari të ndonjë subjekti. Policia e shtetit është e depolitizuar, përcaktim i qartë, që do të thotë ndalim absolut për pjesëmarrje në fushatë, nëse nuk e kupton le të pyesë këshilltarët", -tha Luan Rama. Deputeti i LSI-së tha se Rama po urdhëron policinë që të vjedhë vota, e për këtë, kërkoi reagimin e ndërkombëtarëve,



por edhe të Task-Forcës. "Rama urdhëron policinë të vjedhë vota për Rilindjen, Rama dërdëllit se po bën shtet, por shfaqet si njeri anti-shtet. Kërkojmë nga zv/kryeministria e Task-Forcës, nga ministria dhe policia që të distancohen nga ky qëndrim provokativ dhe humbje të plotë të kontrollit. Policët mos i përgjigjen kësaj përgjigje, por mos guxojë askush të mbledhë vota, as për Rilindjen dhe as për një forcë tjetër, por të zbatojnë ligjin, pasi në të kundër nuk do të këta rilindas që do ta mbrojnë atë rilindas që trafikon vota. Kjo është një deklaratë e turpshme, Rama i papërgjegjshëm. Ftoj trupin diplomatik dhe ambasadorin e SHBA dhe të tjerët të BE, të analizojnë dhe të mbajnë qëndrim publik ndaj shqiptarëve përballë kësaj deklarate provokative kundër ligjit", -tha Luan Rama.



Ilir Meta: Nëse Vasili bëhet kryeministër, dorëhiqem si president

Presidenti i zgjedhur i Republikës, Ilir Meta tha mbrëmë se mund të japë dorëheqjen nëse LSI bëhet forcë e parë politike, dhe nëse Petrit Vasili bëhet kryeministër. I pranishëm mbrëmë në emisionin "Fiks Fare", Meta tha se Ruçi nuk do të arrijë dot të dalë deputet në Fier, për shkak se është i 9-ti në listë, ndaj nuk do të mund të votojë për shkarkimin e Metës si President. "Flas si anëtar më i thjeshtë i LSI-së. Në fund sepse anëtarit të thjeshtë atëherë i bie të flasë, i pari flet kryetari. Tani, më e rëndësishmja është që Shqipëria të ketë një drejtim të ri dhe Petrit Vasili të jetë kryeministër. Pastaj ky shqetësimi se mos i merr një parti të gjitha pushtetet. Jam gati të kontribuoj që të gjejmë një zgjidhje. Unë jap edhe dorëheqjen nga posti i presidentit, boll që LSI-ja të jetë forcë e parë dhe të ketë edhe kryeministrin. Ju e dini që atyre u ka dalë nami që të gjejnë punë, kështu

që do më gjejnë punë edhe mua. Po, e dëgjova dhe kjo mund të ndodhë, por më vjen keq që miku im Ruçi nuk do ketë kënaqësinë të votojë kundër shkarkimit tim se nuk e kam vënë unë të nëntin në listë në Fier", -tha Meta. Si shtoi në bashkëbisedimin me moderatorët dhe konsiderata për Ramën dhe Bashën. "Me Lulin? Patjetër që marrëdhënia ime me Lulin është një marrëdhënie tepër interesante, pasi... E keni parasysh, një fëmijë nuk duhet asnjëherë t'ia marrësh për keq edhe kur bën një gabim. Por ajo që unë mbaj mend është nga Dritëro Agolli në '94, kur Doktori, pika ime e dobët dhe e fortë, lajthiti pak se e kishte edhe për herë të parë në pushtet dhe i donte të gjitha pushtetet për vete dhe Dritëro Agolli shkruajti disa vargje në Kuvend. Unë rrija me Dritëroin gjithmonë pranë tij dhe ai thoshte: "Në vendin tim e në vendin tënd, një kokë e çmendur të



gjithë i çmend". Unë vaksinën e bëra dhe nuk u çmenda, tani është koha për një shans për të gjithë. Do t'i shpëtojmë të gjithë. Së pari, mos prisni që unë të divorcohem nga Doktori, edhe nëse ai divorcohet nga unë. E para kjo. Madje, Lulit ia kam thënë "kujdes, mos u ndaj nga Doktori, se Doktori është shpirti i demokratëve". Përsa i takon sinkronizimit të tyre unë mendoj që është normal dhe po ta kesh mendjen për të thithur gjithë ditën, kuptohet që shushunja ke në mendje. Atë që thithin shushunjat", -tha Meta duke ju referuar kryeministrin në fjalinë e fundit.

Presidenca TIRANE

Paralajmërimi i Ilir Metës se nuk do të dekretojë qeverinë e re të dalë nga zgjedhjet e 25 qershorit ën rast se preken votat, dhe deklarata e Gramoz Ruçit, se nëse e bën këtë, Meta do të jetë presidenti i parë i shkarkuar, kanë hapur një debat edhe mes juristëve. Interpretimet janë të ndryshme. Ka nga ata që thonë se Kushtetuta është e qartë dhe se mosdekretimi apo pjesëmarrja në fushatë e Metës nuk përbën shkak për shkarkim, ndërsa të tjerë mendojnë se Kushtetuta lë mundësi të hapura për këtë çështje. Disa shkojnë edhe më tej në skenarët e situatës politike, teksa thonë se Meta mund të japë dorëheqjen. Pjesë e këtij debati është bërë edhe ish-ministri i Drejtësisë Ylli Manjani me anë të një postimi në Twitter, i cili i kujton Ruçit se me Kushtetutë shkarkimi i Presidentit kërkon 93 vota. "Nuk e di për kushtetutën e Fierit, por ajo Shqipërisë thotë se: Shkarkimi i Presidentit të Republikës vendoset nga 93 deputetë".

ARGUMENTET KUNDËR

Konstitucionalisti Sokol Hazizaj e konsideron deklaratën e kreut të grupit të PS Gramoz Ruçi për shkarkimin e Metës nga Presidenca si një qëndrim në frymën e fushatës elektorale por të pamundur për tu realizuar. Gjatë një interviste për Report Tv, Hazizaj thotë se Ilir Meta ende nuk e ka marrë detyrën e Presidentit, por edhe nëse do ta kishte marrë Kushtetuta ka parashikime të qarta kur mund

Skenarët e ikjes së Metës, nga shkarkimi deri tek dorëheqja

Skënder Gjinushi: Meta drejt dorëheqjes, Hazizaj: Shkarkimi i pamundur! Manjani: Duhet 93 vota



Skënder Gjinushi

të shkarkohet një President. Ky nuk është rasti thotë ai. "Të flasësh për shkarkimin e presidentit, kur ende mandati i presidentit të ri, i cili është i barasvlershëm në kohë me betimin tij para Kuvendit, më duket se është e nxituar dhe elektorale e emocionale, se sa e vërtetë. Presidenti largohet nga detyra kur është i sëmurë rëndë, kur aktet e tij

janë në kundërshtim të thellë me ligjet dhe Kushtetutën, ejt, që janë raste me karakter të përgjithshëm. Nuk mendoj se në këto raste mund të bëjë pjesë presidenti i zgjedhur sot", -tha Hazizaj.

ARGUMENTET PRO

Juristë të tjerë thonë se, ndonëse Ilir Meta është president i zgjedhur, ekziston një mekanizëm fare i lehtë Kushtetues, përmes të cilit Partia Socialiste dhe ajo Demokratike mund të vendosin të largojnë Metën nga detyra e Presidentit ende pa marrë detyrën. Konkretisht, neni 88, pika dy e Kushtetutës parashikon se Presidenti fillon zyrtarisht detyrën e tij vetëm pasi bën betimin, 60 ditë pas zgjedhjes në këtë detyrë. Më tej, pika tre e të njëjtit nen përcakton formulën e betimit. Konkretisht, Meta duhet të bëjë betimin e tij përpara Parlamentit në datën 24 korrik. Megjithatë, nëse Partia Socialiste dhe ajo Demokratike vendosin të mos paraqiten në atë seancë, nuk ka asnjë mënyrë për Metën që ai të bëjë betimin dhe të marrë kështu funksionet e kreut të shtetit. Në pamundësi për të bërë betimin, Presidenti humbet automatikisht funk-



Sokol Hazizaj

cionet dhe parlamenti i ri do të ketë detyrën që të zgjedhë një President të ri.

DORËHEQJA

Kreu i Partisë Social Demokratike, Skënder Gjinushi, gjatë një interviste mediatike, tha se Ilir Meta praktikisht mund të japë dorëheqjen nga posti i Presidentit dhe de fakto e ka bërë këtë. "De fakto ilir

Meta ka dhënë dorëheqjen nga Presidenti. Në fillim tha se do të rrijë derisa të bëhet betimi dhe pastaj e kapi situatën dhe tha që nesër unë largohem. Presidenti i Republikës është në konflikt të plotë të interesit që të dalë në krye të një partie politike në fushatë zgjedhore. Dhe për më tepër të kërcënojë me mandatin e Presidenti. Ky është shpërdorimi më i madh që mund t'i bësh Presidentit të Republikës. Unë mendoj që Ilir e ka në mend të japë dorëheqjen. Ka zgjedhur t'i rikthehet LSI-së" - tha Gjinushi. Se si do të vijojë ky debat, do të duhet të presim të paktën 24 korrikun për të parë se cili skenar mund të konkretizohet.

KUSHTETUTA

Neni 90 i Kushtetutës thotë se: "1. Presidenti i Republikës nuk ka përgjegjësi për aktet e kryera në ushtrim të detyrës së tij. 2. Presidenti i Republikës mund të shkarkohet për shkelje të rëndë të Kushtetutës dhe për kryerjen e një krimi të rëndë. Propozimi për shkarkimin e Presidentit në këto raste mund të bëhet nga jo më pak se një e katërta e anëtarëve të Kuvendit dhe duhet të mbështetet nga jo më pak se dy të tretat e të gjithë anëtarëve të tij. 3. Vendimi i

Meta:

"Rama ka marrëdhënie të vështira me fqinjët"

Për fat të keq, Rama ka marrëdhënie të vështira me të gjithë dhe të paqëndrueshme, përfshirë dhe Greqinë, por jo vetëm Greqinë, por dhe fqinjë të tjerë". Kështu është shprehur Presidenti i zgjedhur, Ilir Meta në një intervistë për televizionin grek "STAR". Meta shprehet se ka qenë e pamundur, që Rama të tregonte vetëpërmbytje në sjelljen e tij si kryeministër. "Ka qenë për fat të keq, i pamundur për të treguar vetëpërmbytje, tolerancë në sjelljen e tij si kryeministër brenda vendit. Unë jam forcuar shumë për të shmangur konfrontime, të cilat mund të kishin sjellë një situatë tepër të rëndë në Shqipëri, siç ishte në radhë të parë dëshira e tij për të miratuar një reformë në drejtësi, duke përjashtuar opozitën nga një reformë kaq historike që do të kishte sjellë një konflikt tepër të rëndë", -deklaroi Meta. Ai vijon më tej intervistën duke thënë se marrëdhënia me Greqinë është jetike për Shqipërinë.

Kuvendit i dërgohet Gjykatës Kushtetuese, e cila, kur vërteton fajësinë e Presidentit të Republikës, deklaroi shkarkimin e tij nga detyra".

Degjeneron fushata kandidati i PS kërkon vota në zyrat e PD dhe LSI

Incidenti me Hysenin denoncohet nga ministri Dervishaj: Provokoi vajzën duke e ftuar në zyrë



Kandidati i PS-së, Alket Hyseni duke hyrë në qendrën elektorale të PD-së



Një provokim të shëmtuar, të panevojshëm dhe të paprecedentë që ka përfunduar në selitë diplomatike në Tiranë dhe në zyrën e OSBE-ODIHR-it, ka kryer kandidati i PS-së për Sarandën, Alket Hyseni. Kandidati i cili renditet i treti në qarkun e Vlorës dhe nuk është nën presionin e humbjes së mandatit, ka kryer veprime tallëse dhe provokuese ditën e djeshme, ku ka hyrë në zyrën elektorale të Partisë Demokratike dhe të LSI-së, ku ka kërcënuar, fyer dhe provokuar stafin elektorale të partive të tjera,

si dhe mbështetësit e tyre. Ky kandidat që e ka mandatin thujtë të sigurt e nuk ka nevojë të sforcet me ngjarje të tilla të shëmtuara, ka zhvilluar prej kohësh një fushatë ekstravagante e luksoze në Sarandë, por të gjitha këto nuk i kanë mjaftuar. Me arrogancë e mos kokëçarje, Hyseni i shoqëruar nga stafi i tij, ka hyrë në zyrën elektorale të PD-së, dhe në atë të LSI-së, ku ka fyer një 18 vjeçare të pranishme, dhe më pas i ka kërkuar asaj të shkojë në një takim në zyrën e tij të rilindjes. "Eja jashtë. Çfarë kërkon ti në këtë parti? Eja. Të pres tek zyra ime në PS", -mësohet t'i ketë thënë

Hyseni, Esmeraldës, vajzës së LSI. Burimet bëjnë me dije se Hyseni ka shkuar në shtëpinë e prindërve të 3 kandidatëve të LSI-së, dhe ju ka thënë: "Fëmija juaj e ka bërë një gabim. Ju mos e bëni. Thojini të vijë në zyrën time, sepse unë kam një ofertë më të mirë për të. Keni kohë të ndryshoni mendim", -ju ka thënë Hyseni. Ky akti i konsumuar nga Hyseni dhe stafi i tij, fatmirësisht

ka kaluar pa konflikte fizike, për shkak se në partitë e tjera ku ai ka shkuar, stafi ka qenë femëror, por për shkak të denoncimit që LSI i ka bërë pranë ambasadave dhe ODIHR-it, ky gjest ka cenuar rëndë figurën e kandidatit, Partisë Socialiste dhe procesit të qetë zgjedhor. Rasti është denoncuar nga kandidati i LSI-së për këtë bashki, Sokol Dervishaj. Ai tha se për këtë ngjarje kishte njoftuar ambasadat.

DERVISHAJ

Ministri i Transporteve, Sokol Dervishaj, në një denoncim publik i referohet Alket Hysenit si Uriah Hipi (personazh i një libri të njohur). "Të frikësuar nga humbja e thellë që do kenë në Sarandë dhe gjithë Shqipërinë, rilindja ka rënë në dëshpërim të thellë. Jo më larg se sot kandidati rilindas për Sarandën me arrogancën e pushtetit, ka shkuar në zyrat e LSI dhe i ka bërë presion Esmeraldës aktivistes së LRI. Uriah Hipi, përveç ofendimeve i ka lënë takim 18 vjeçares në zyrën e rilindjes! A kuptoni miq, ku ka degjeneruar rilindja. Por ky nuk është rasti i vetëm i presioneve ndaj LSI, ka me dhjetëra në Sarandë dhe qindra në gjithë Shqipërinë. Edhe ndaj kandidatëve të LSI dhe familjeve të tyre. Ky rast i shëmtuar presioni por edhe raste të tjera të shantazhit dhe presionit ndaj mbështetësve të LSI Sarandë,



Detajet

KOMUNIKIMI

"Eja jashtë. Çfarë kërkon ti në këtë parti? Eja. Të pres tek zyra ime në PS", -mësohet t'i ketë thënë Hyseni, Esmeraldës, vajzës së LSI. Burimet bëjnë me dije se Hyseni ka shkuar në shtëpinë e prindërve të 3 kandidatëve të LSI-së.



PRINDËRVE

Prindërve të kandidatëve Hyseni ju ka thënë: "Fëmija juaj e ka bërë një gabim. Ju mos e bëni. Thojini të vijë në zyrën time, sepse unë kam një ofertë më të mirë për të. Keni kohë të ndryshoni mendim", -ju ka thënë Hyseni.

i janë dërguar OSBE/ODIHR dhe gjithë ambasadave. Dua ti bëj thirrje Uriah Hip-it të tërhiqet nga presionet ndaj LSI, sa nuk është vonë, sepse LRI nuk i trembet asnjë presioni ardhur nga oligarkët. Sulme të tilla na bëjnë më të fortë që në 25 qershor, bashkë me shqiptarët të votojmë numrin 1, sepse shqiptarët janë një popull me virtyte të larta dhe të lashta, dhe nuk mund të durojnë shfaqje të tilla. Uriah Hip-it i them të mos e shpërdorë emrin e mirë dhe fisnikërinë e popullit të Tepelenës. Kjo shfaqje e shëmtuar nuk është Shqipëria që duam. Më 25 qershor të gjithë së bashku rreth numrit 1, për një shtet me dinjitet dhe 1 shans për të gjithë", -shkruan Sokol Dervishaj.

Provokimi i Alket Hysenit denoncohet në OSBE-ODIR

Justifikohet kandidati: Kam të drejtë të shkojë derë më derë

Kandidati i PS-së, Alket Hyseni është përpjekur të justifikojë provokimin e tij me argumentin se po troket derë më derë për të kërkuar votat e shqiptarëve. Është ironike të besosh se

një kandidat me profil serioz kërkon vota për PS-në në zyrat elektorale të LSI-së dhe PD-së, ku qëndrojnë njerëzit më besnikë dhe më të përkushtuar të partisë. "Nuk do të reshtim asnjë herë të trokasim derë më derë, shtëpi më shtëpi, dyqan më dyqan për të takuar votuesit tanë. Sot ishim në lagjen Kodër, në rrugën Bilal Xhaferri, ku shtrëngojmë dorën me qindra qytetarë. Çdo ditë e më shumë njerëz po i bashkohen Partisë Socialiste. Njerëz, të cilët presin që ne të mbajmë të vetëm timonin e reformave dhe të qeverisim vendin. Ne jemi Partia Socialiste, familja më

madhe politike e Shqiptarëve. Rivalët tanë që dalin fshehurazi natën, joshin njerëzit me vende pune inekzistente dhe blejnë vota, janë tmerruar nga takimet tona me njerëzit dhe mbështetja masive e popullit të Sarandës. Ne bëjmë takime hapur, ditën për ditë, dëgjojmë problematikat e qytetarëve dhe prezantojmë programin tonë qeverisës. Ne bëjmë shtet të fortë, rrisim ekonominë, punësimin dhe mirëqenien ndaj kemi mbështetjen absolute të popullit", -thotë Hyseni. Ai e mbyll qëndrimin me shprehjen se qentë do të lehin dhe ai do të eci përpara. "Më 25 Qershor

perëndon periudha e partive shushunja që duan medoemos të hyjnë në oborrin e pushtetit për të vazhduar të ushqehen, rriten, forcohen duke mbajtur duart në tepsinë e pushtetit. Më 25 Qershor këto parti do të marrin vendin që meritojnë. Kemi bërë shumë. Më shumë akoma mbetet për të bërë. Po ka edhe shumë për të humbur, nëse Partia Socialiste nuk mban, pa të tjerë në prehër, timonin e reformave. Siç luftuam dhe fituam për Vetëqeverisjen, do të luftojmë e fitojmë për të rritur ekonominë dhe punësimin si asnjëherë më parë. Qentë le të lehin, karvani ecën përpara", -thotë Hyseni.

SHËRBIMI PËRMBARIMOR "ASTREA"

NJOFTON SHPALLJEN E ANKANDIT 2 PËR:

Ndertese me sipërfaqe 213 m², me nr.pasurie 404/25, Vol. 6, Faqe 112, Zona Kadastrale: 1377 me adresë Çerkeze, Tirane. Çmimi me të cilin fillon ankandi është **596,400 (peseqind e nentëdhjete e gjashte mijë e katerqind) Leke.**

Ankandi do të zhvillohet më datë **17.07.2017, Ora 16:00**, pranë Shërbimit Përmbarimor "ASTREA" shpk, Rr. "Kajo Karafil" Pll.pas Lidhjes se Shkrimtareve, Hyrja 1, Kati 2, Zyra 1004 Tiranë.

Për çdo informacion mund të kontaktoni cel.0696334695 email: sherbimipermbarimorastrea@gmail.com

SHËRBIMI PËRMBARIMOR "ASTREA"

NJOFTON SHPALLJEN E ANKANDIT 3 PËR:

Ndertese me sipërfaqe 472.5 m² kati 1 dhe 485 m² kati 2, Zona Kadastrale: 8523, Numri i Pasurisë: 17/444, Vol. 32, Faqe 48 me vendodhje Lagja 28-NENTORI, Elbasan. Çmimi me të cilin fillon ankandi është **16,267,608 (gjashtembjedhete milion e dyqind e gjashtedhjete e shtate mijë e gjashteqind e tete) Lekë.**

Ankandi do të zhvillohet më datë **28.06.2017, Ora 16:00**, pranë Shërbimit Përmbarimor "ASTREA" shpk, Rr. "Kajo Karafil", Pallati pas Lidhjes te Shkrimtareve, Hyrja 1, Kati 2, Zyra nr.1004, Tiranë.

Për çdo informacion mund të kontaktoni cel.0696334695 e-mail: sherbimipermbarimorastrea@gmail.com

Lulzim Basha: S' bëjmë koalicion me PS dhe LSI

Kreu i Partisë Demokratike eklipson Sali Berishën, i merr meritat për Rrugën e Kombit

ADRIATIK DOÇI
TIRANE

→ LULZIM BASHA

→ AKUZA RAMËS

Kryetari i Partisë Demokratike, Lulzim Basha, ka përjashtuar mundësinë e një koalicioni paszgjedhor me Partinë Socialiste dhe Lëvizjen Socialiste për Integrim. Nga Kuçova, ku mori pjesë në një takim elektorale, Basha tha se nuk do të bëjë pazar as me PS dhe as me LSI. "Mos dëgjoni sirenat se flasin për pazare dhe koalicione. Republika e vjetër është bërë reçe dhe nuk kanë pikë turpi, kanë mbetur në derë të Republikës së Re duke kërkuar dorën. Si thoni t'ua dorën? Jo, do u japim bërrylin. Kjo lëvizje nuk është e imja, por e qytetarëve. Jo pazar me Ramën dhe Metën, por Republikën e Re të qytetarëve shqiptarë. Nuk do të bëjmë pazar as me PS as me LSI. Do të mendojmë vetëm për interesat tuaja", tha Basha. Reagimi i Bashës vjen në një kohë kur qarkullojnë zëra për një koalicion të mundshëm mes PD dhe PS pas zgjedhjeve. Ndërkaq, nisur nga akuzat e ditëve të fundit, mundësitë

"Për 2 vjet, mora përsipër dhe u dhashë shqiptarëve Rrugën e Kombit. Nuk ka pasur plan për ju, por vetëm për veten e tij dhe një grusht pushtetarësh, oligarkësh dhe kriminelësh".

për një koalicion të mundshëm mes PS dhe LSI, pas zgjedhjeve, janë të pakta.

PËR RRUGËN E KOMBIT

Kryetari i Partisë Demokratike, Lulzim Basha, prezantoi dje në Vlorë planin e tij ekonomik, për ta vënë në zbatim pas zgjedhjeve të 25 Qershorit, gjithnjë nëse shqiptarët do t'i besojnë opozitës qeverisjes e vendit. Basha tha se plani i tij është i njëjti me planin që zbatohet në Gjermani dhe në SHBA, i cili ndez motorët e ekonomisë. Por, gjatë fjalës së tij, Basha mori meritat e ndërtimit të Rrugës së Kombit. Me këtë projekt, deri më sot, është identifikuar emri i Sali Berishës, ndërsa emri i Bashës lidhet kryesisht me abuzimin e madh financiar me këtë rrugë. Megjithatë,

Erdhëm dhe çfarë pamë sot? Palma të thara, pllaka. Nuk pamë turistë, por pensionistë që ulen në kafe pa para për ta paguar. Pamë të rinjtë pa punë pa leje pa shpresë dhe të dëshpëruar.

Basha u shpreh dje se u ka dhënë shqiptarëve Rrugën e Kombit. "Vendet e punës do të hapen, studentët do ti garantojmë universitetin me tarifa të përbalueshme dhe stazhe pune, pensionet do të rriten sepse ne kemi një plan dhe jo premtime. Një plan ekonomik të hartuar nga ekspertët më të mirë shqiptarë, me ndihmën më të mirë evropiane dhe ju e patë se këtu ishte Falenski, këshilltari i grupit parlamentar të CDU, të Angela Merkel. Një plan ekonomik të ngjashëm me ato që kanë nxjerrë vende nga krizat. Një plan ekonomik të ngjashëm që po aplikon sot Presidenti Trump në SHBA, me ulje taksash, me ndihmë për sipërmarrjen për të krijuar vende pune, me ndihmë për investimin në infrastrukturë. Këto janë prioritetet. Pal-

mat dhe lungomaret, janë turpi dhe treguesi kur mendon vetëm për veten tënde, tekat dhe xhepat e tu. 4 vite nuk e mbaroi dot. Për 2 vjet, mora përsipër dhe u dhashë shqiptarëve Rrugën e Kombit. Nuk ka pasur plan për ju, por vetëm për veten e tij dhe një grusht pushtetarësh, oligarkësh dhe kriminelësh", tha Basha. Nga Vlora, Basha ka akuzuar se Rama po lë pas vetëm palma të thara. "Erdhëm dhe çfarë pamë sot? Palma të thara, pllaka. Nuk pamë turistë, por pensionistë që ulen në kafe pa para për ta paguar. Pamë të rinjtë pa punë pa leje pa shpresë dhe të dëshpëruar. 4 vite më parë Rama erdhi këtu dhe premtoi 300 mijë vende pune e shumë të tjera por ai sot në Vlorë nuk flet më për to, sepse i shkeli të gjitha premtimet", pohoi Basha.

TAKSAT

Kryedemokrati tha se taksat do të ulen duke rritur paratë në xhepat e shqiptarëve. Sipas tij, do të ketë më shumë vende pune, pensione të larta, ndihmë ekonomike më të madhe, stazhe për të rinjtë, para në dorë për fermerët. Ai tha se investitorët amerikanë dhe evropianë presin këtë plan të zbatohet në Shqipëri. "Ky plan



ekonomik bën rishpërndarjen e parave dhe i kthen paratë te njerëzit, konsumatorët, te pensionistët. Ky është plani ekonomik me të cilin ne do e nxjerrim Shqipërinë nga kriza, me të cilin ne do të rrisim punësimin, do të sigurojmë që industrinë e zhvilluar të investojmë në Shqipëri. Kam takuar disa investitorë të rëndësishëm në SHBA gjatë vizitës 2 ditore atje dhe të gjithë presin me padurim që a do jetë në gjendje Shqipëria të plotësojë këtë plan. Me uljen e taksave dhe TVSh-së, menjëherë nis injektimi i miliona eurove që sot zhduken në xhepat e qeverisë së korrupsuar të Edi Ramës. Këto para do të jenë në xhepat tuaj. 400 milionë euro më shumë për të shpenzuar çdo vit vetëm me uljen e TVSh-së", tha Basha.

PËR PRONAT

Nga Vlora Basha tha se do të hiqet e taksat mbi shitblerjen e pronës e cila ka bllokuar tregun dhe do ketë vetëm një taksë simbolike. Po ashtu, TVSh-ja për paketat turistike që sjellin turistë të huaj, do të hiqet. "Nuk do ketë më taksë transferimi prone dhe shitblerja e pronës do ketë një tarifë fikse prej 300 mijë lekësh të vjetra dhe qëllimi do të jetë që të qarkullojë prona që njerëzit të shesin e të blejnë. Ne do të heqim TVSh-në për paketat që marrin turistë të huaj për të ardhur këtu", tha Basha. Ai u shpreh nga Vlora se do të anulohet edhe moratoriumi i gjuetisë i cili ka nxitur informalitetin dhe ka penalizuar turizmin. Do ndalojmë drogën, do luftojmë krimin, do lejojmë gjuetinë e ligjshme, tha Basha.

FUSHATA / KREU I PR: OPOZITA DO TË FITOJË ZGJEDHJET

Fatmir Mediu: Për herë të parë në 27 vite thirrje që të votohet PD

Kryetari i Partisë Republikane, Fatmir Mediu i ftuar në Report TV në emisionin "45 Minuta" e cilëson si një mbështetje të SHBA, foton e Bashës me Donald

Trump. "Errallë në historinë e politikës shqiptare që opozitës t'i jepet një mbështetje e tillë nga SHBA" u shpreh ai. Për sa i përket shqetësimit të Hoyt Brian Yee për ndikimin

e Moskës në Ballkan, Mediu thotë se shqetësimi rus është permanent, shpesh ngritja e tensioneve etnike dhe zhvillimet në rajon kanë krijuar një shqetësim të SHBA, e cila është investuar në Ballkan. Por si e shikon Mediu një qeverisje të përbashkët mes PS dhe PD pas zgjedhjeve? "Bashkëpunimi dhe komunikimi politik është i domosdoshëm mes shumicës dhe opozitës, pastaj koalicioni është çështje tjetër. Unë kam bindjen se opozita do të fitojë zgjedhjet dhe nuk ka nevojë për një koalicion të madh. Qeveria e madhe për çfarë? Integrimi është një kauzë e madhe, por kuptimi është një kënaqësi që duhet t'i japim Brukselit, bashkëpunimi duhet të bazohet te rritja ekonomike", deklaroi ai. PR këto zgjedhje do të garojë në siglën e PD, ndërsa Mediu thotë se për herë të parë u bën

→ PËR METËN

"Mendoj që Presidenti nuk është lojë politike dhe është e rëndësishme si sillet dhe nuk kam ndërmend të japë një mendim për deklaratat, janë të nxituara deklarata të tilla, nuk ulin tensionet, por i ngrenë".

thirrje votuesve të votojnë PD. "Për herë të parë në 27 vite bëj thirrje që të votohet PD", pohoi ai. Mediu komentoi edhe akuzat brenda koalicionit PS-LSI dhe deklaratat e Ruçit se Meta mund të shkarkohet. "Kemi 4 vite qeverisje, krim, korrupsion, drogë, dëgjoni Metën dhe Ramën për akuzat dhe kundër akuzat. Mendoj që Presidenti nuk është lojë politike dhe është e rëndë-



sishme si sillet dhe nuk kam ndërmend të japë një mendim për deklaratat, janë të nxituara deklarata të tilla, nuk ulin tensionet, por i ngrenë", tha ai. Por a do të bënte PD një

koalicion me LSI pas zgjedhjeve? "Vlen për ta analizuar PD një qeverisje me LSI. Nëse e shikojmë si çështje numrash nuk u shërben qytetarëve", përfundoi ai.

SHOQËRIA PËRMBARIMORE "616/A" SHPALL PËR SHITJE NË ANKAND PASURINË E PALUAJTSHME:

Njësi me sip.60 m2, nr. pasurie 1/185-N1, vol.28, faqe nr.143 e ndodhur në zonën kadastrale nr.8582 Lagjja nr.3, Pogradec.

Vlera fillestare e pasurisë është 3,360,000 lekë (Tremiljo n e treqind e gjashtëdhjetë mijë)

ANKANDI ZHVILLOHET DITËN E HËNË NË DATË 10.07.2017

Personat e interesuar mund të paraqiten në adresën Lagjja Nr.3, Rruga "Andon Xoxe", Pogradec ose të kontaktojnë : Cel:0682223020, e-mail: shoqeria616a@gmail.com

Zguri: Partitë politike po vështirësojnë punën e KQZ

Fletët e votimit mbërrin sot në Shqipëri, KQZ njofton Policinë e Shtetit

ANDUELA NDREU
TIRANE

Jemi 10 ditë larg zgjedhjeve, por KQZ vë alarmin. "Partitë politike po vështirësojnë punën e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në administrimin e procesit të 25 qershorit". Shqetësimi ka ardhur nga kreu i KQZ, Klement Zguri

i cili në një intervistë për Report Tv u kërkon subjekteve të respektojnë ligjin dhe të sjellin propozimet e tyre për këtë proces. Kreu i KQZ shprehet që mos-reflektimi

i partive të detyrojë KQZ të bëjë emërimet nga Shoqëria Civile. Zguri u bën apel partive politike të zbatojnë ligjin e të sjellin komisionerët e niveleve të dyta e të treta. Kjo situatë

thotë Zguri gjatë një interviste për Report Tv është krejtësisht e papranueshme dhe se po vështirëson procesin e administrimit të zgjedhjeve nga KQZ. "Janë detyrime

që u takojnë partive politike, pasi e dimë që nivelet e dyta e të treta administrohen nga partitë politike. Të paktën propozimet e personave janë të partive politike, edhe pse jam i detyruar të them shpesh, se partitë politike abuzojnë me të drejtat që kanë në proces. E them, shfrytëzoj rastin t'u drejtohem subjekteve zgjedhore që në mënyrë urgjente të reflektojnë. Jemi në zgrip, në pjesën fundore, në pjesën limit të kohës, sepse jo vetëm propozohen komisionerët, por duhet dhe të trajnohen. Sepse debati teknik aq i rëndomtë që duhet të zhvillohet në momente te caktuara të procesit kthehet në debat politik dhe për shkak se komisionerët janë aty, nuk dinë asgjë nga procedura por thjesht zbatojnë urdhrat nga liderët e tyre politikë. Këtë KQZ nuk e pranon dhe duam me të gjitha mjetet të ndërgjegjësojmë subjektet zgjedhore për këtë të drejtë që ligji u ka dhënë. Të shpresojmë që kjo të jetë thirrja e fundit dhe partitë të reflektojnë dhe të përcjellin detyrimet e tyre", tha Zguri. Ndonëse ka marrë drejtimin e KQZ në një situatë të relaksuar politikisht pas marrëveshjes mes PS e PD, Zguri kërkon që ky vullnet të reflektohet edhe nga partitë duke sjellë propozimet për komisionerë. "Në rast të kundërt paralajmëron kreu i KQZ, ky institucion mund



Detajet

PARTITË

"Nivelet e dyta e të treta të procesit zgjedhor administrohen nga partitë politike. Të paktën propozimet e personave janë të partive politike, edhe pse jam i detyruar të them shpesh, se partitë politike abuzojnë me të drejtat që kanë në proces".

KOMISIONERËT

"Sepse debati teknik aq i rëndomtë që duhet të zhvillohet në momente te caktuara të procesit kthehet në debat politik dhe për shkak se komisionerët janë aty, nuk dinë asgjë nga procedura, por thjesht zbatojnë urdhrat nga liderët e tyre politikë".

të detyrohet të zëvendësojë komisionerët me shoqëri civile. Kreu i KQZ thotë se puna e KQZ është në zbatim të ligjit, dhe raste ekstra-ligjore kishin e të bënin me ndryshimin e afateve për regjistrimin e subjekteve në KQZ apo edhe listave të kandidatëve". Sot mbërrin nga Shqipëria fletët e votimit për procesin e 25 Qershorit. Kreu i KQZ konfirmon se për këtë proces janë njoftuar edhe e institucionet e tjera të zbatimit të ligjit siç është Policia e Shtetit. Zguri u kërkon partive politike dhe mediave të jenë të pranishëm në këtë moment për të ndjekur transparencën e këtij procesi.

Situata

Hoxhaj: Komisionerët të vijnë sot në trajnim, të njohin ligjin

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve po ndjek në dinamikë situatën sa i përket emërimeve të anëtarëve të KQZ. Pas apelit të dy ditëve më parë, ka reagim pozitiv nga ana e partive politike, por ende vijojmë të jenë disa KZAZ pranë të cilave nuk janë depozituar propozimet komisionerët të QV-ve. "Edhe pse nuk jemi në kushtet që të gjithë komisionerët të jenë të emëruar, KQZ ditën e nesërme (sotme) do të fillojë zbatimin e skemës së trajnimit, e cila i është vënë në dispozicion të gjitha KZAZ-ve, partive politike që propozojnë anëtarët e KQV-ve dhe misionit të vëzhgimit të OSBE/ODIHR-it. Komisionerët e qendrave të votimit të marrin pjesë në mënyrë aktive në trajnim, pasi rritja e tyre profesionale dhe njohja e mirë e ligjit, ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë


në mirëadministrimin e procesit zgjedhor dhe në arritjen e standardeve të kërkuara zgjedhore", tha zëdhënësjë Drilona Hoxhaj. KQZ ndryshe nga vitet e tjera, ka parashikuar që trajnimi do të zhvillohet në oraret e pasdites, 16.00-18.30, me qëllim për të shmangur pengesat për të marrë pjesë në trajnim. Trajnimit do të zhvillohen në ambientet e shkollave, gjë e cila u arrit në sajë të bashkëpunimit me Ministrinë e Arsimit. "Sa më sipër, KQZ ripërsërit apelin për partitë politike që të dorëzojnë brenda ditës së sotme të gjithë propozimet për komisionerët e Qendrave të Votimit pranë KZAZ-ve përkatëse. Njëkohësisht apeli shkon edhe për komisionerët, të cilët pjesëmarrjen në trajnim e kanë detyrim të ngarkuar nga Kodi Zgjedhor", tha Hoxhaj.



FUSHATA

Shkarkohet drejtori i spitalit Gjirokastrë dhe një drejtor i MAS

Ministria e Shëndetësisë e drejtuar nga Arben Beqiri i propozuar nga PD si ministër teknik ka shkarkuar drejtorin e spitalit të Gjirokastrës, Krenar Kulla. Ai është shkarkuar me motivacionin se ka marrë pjesë në fushatën e LSI që po zhvillohet në Krenar Kulla. Krenar Kulla mban postin e kryetarit të LSI në qytetin e Gjirokastrës, ndërsa është dokumentuar nga ministria e Shëndetësisë se ka marrë pjesë në fushatë për këtë parti. Në vendin e tij është emëruar nga Ministria e Shëndetësisë, Përparim Muço. Ndërkohë, ministrja e arsimit, Mirela Karabina, për angazhim në fushatë ka shkarkuar një prej drejtorëve më të rëndësishëm të MAS. "Në vijim të njoftimit të datës 15.06.2017 lidhur me depozitimin e Kallëzimit Penal me Nr. 8012, datë 14.06.2017 për shtetasin Alqi Kushi, me funksion Drejtor i Përgjithshëm i Shërbimeve Mbështetëse pranë kësaj ministrie, sot, më datë 16.06.2017 Ministrja e Arsimit dhe Sportit zonja Mirela Karabina, ka urdhëruar me Urdhër Nr. 335 datë 16.06.2017, pezullimin e menjëhershme të z. Kushi nga detyra e drejtorit të përgjithshëm të shërbimeve mbështetëse në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit", thuhet në njoftim.



Krenar Kulla

Përdori anijen për propagandë Mandija: Të lirohet Gazmir Tahiri

Anija çoi të rinjtë e FRESSH-it të Vlorës në ishullin e Sazanit në maj

Zëvendëskryeminstri Mandija i kërkon ministrin të Transportit Sokol Dervishaj lirimin nga detyra të Drejtorit të Drejtorisë së Përgjithshme Detare, Gazmir Tahiri. Mandija kërkon lirimin e tij, pasi në datën 27 Maj nga Porti i Vlorës ka dalë për lundrim një anije, e cila është pronë e kapitanerisë së porteve, në të cilën disa të

rinj, simpatizantë të një subjekti politik në praninë e një kandidat për deputet, propagandojnë dhe manifestojnë me simbole partiake. Burime për Shqiptarja.com bëjnë me dije për një udhëtim që të rinjtë e PS-së së Vlorës kanë bërë për në ishullin e Sazanit, në prani edhe të drejtuesit politik, ministrit Damian Gjinknuri. Zëvendëskryeminstri Mandija deklaroi se shkëlqen e ka të dokumentuar edhe me pamje filmike, kur anija ka dalë për lundrim me simpatizantët e subjektit politik në praninë e kandidatit për deputet. Ditët e fundit Ledina Mandija ka urdhëruar pezullimin dhe shkarkimin e disa drejtorëve në administratë për përfshirje në fushatën e zgjedhjeve të 25 qershorit. "Zëvendëskryeminstri



trja Ledina Mandija, në cilësinë e drejtuesit të Task Forcës, i kërkoj Ministrin të Transportit dhe Infrastrukturës, Sokol Dervishaj, shkarkimin nga detyra të Drejtorit të Drejtorisë së Përgjithshme Detare, Gazmir Tahiri, i cili referuar informacioneve në kundërshtim me pikën 13 të VKM-së Nr.473, datë 1.06.2017 ka

vënë në dispozicion të një subjekti elektoral mjete, të cilat janë pronë e administratës shtetërore. Zëvendëskryeminstri i kërkon Ministrin Dervishaj të marrë masa në mënyrë të menjëhershme si dhe referimin e rastit pranë organeve të Prokurorisë së Përgjithshme", thuhet në njoftimin e zëvendëskryeminstres.

Zgjedhjet, shefi i ODIHR: Pakti PS-PD futi në vështirësi KQZ

Peter Tejler: ODIHR po monitoron udhëtimet falas. Kemi informacione për presione në administratën shtetërore

Marrëveshja politike Rama-Basha ka vënë në vështirësi punën e komisionit qendror të zgjedhjeve. Shkak janë ligjet kontradiktore mes tyre për të njëjtën çështje, të cilave KQZ duhet t'i referohet për të marrë vendim. Konstatimi vjen nga shefi i misionit të ODIHR, ai që do të vejë notën për zgjedhjet e 25 qershorit, Peter Tejler. Në një intervistë për REPORT TV Tejler thotë se si pasojë e kësaj marrëveshje një sërë institucionesh e kryesisht KQZ janë përballur me sfida.

Por ai shman një përgjigje të prerë për sa i përket ndryshes së numëruesve mes LSI e PDIU. "Më lejoni të them që si rezultat i marrëveshjes politike, KQZ është përballur me një sërë sfidash. Ka disa kontradikta në ligjet në fuqi. Në lidhje me pyetjen tuaj, dimë që ka ankesa nga partitë politike. Ne po e ndjekim këtë proces dhe ne do të vlerësojmë mbarëvajtjen e tij. Procesi është në vazhdim dhe do ta ndjekim nga afër" tha ai.

"KEMI INFORMATA PËR PRESIONE NË ADMINISTRATË"

Tejler pohon gjithashtu se ka informacione se nga partitë po ushtrohet presion mbi administratën. Por vërtetësinë e tyre do ta verifikojnë. "Siç e dini edhe ju, ne kemi një numër të caktuar vëzhgues afatgjatë të angazhuar në vend. Ne po e ndjekim situatën edhe prej këndej. Kemi informata për presione të ndryshme. Dimë që ka institucione që po i ndjekin me kujdes këto pretendime qofshin të drejta apo të gabuara. Është shumë e rëndësishme që ne të kemi një panoramë të plotë përpara se të bëjmë një vlerësim. Ky është proces i vazhdueshëm. Ka institucione shtetërore që po merren me këtë çështje. Gjithashtu ka mënyra të tjera për njerëzit që duan të adresojnë këtë çështje apo të dorëzojnë ankesat e tyre. Ne po i ndjekim këto nga afër".

Kush po e bën këtë presion? "Kush po bën presion. Ne jemi në fushatë, ndaj të folurit për këtë presion, nuk është në mandatin tonë. Ne duam të kuptojmë dhe të krijojmë një panoramë të plotë mbi çfarë është e vërtetë dhe çfarë nuk është e vërtetë dhe sigurisht se si sistemi trajton këto pretendime, informacione dhe ankesa. Në ditën pas zgjedhjeve ne do të publikojmë një deklaratë për gjetjet paraprake së bashku me delegacionin parlamentar, dhe këtë çështje mund ta trajtojmë atëherë. Është e rëndësishme të kuptohet se ne po ndjekim procesin dhe kjo është arsyeja përse ne ndodhemi në vend për një periudhë të gjatë. Ky proces po ndodh tani dhe ne po e ndjekim si dhe shqyrtimin e ankesave".

Si e shikon OSBE-ODIHR ndarjen e komisioneve të grupeve të numërimit midis LSI - PDIU, një parti që në zgjedhjet e kaluara figuronte si opozitë?

Më lejoni të them që si rezultat i marrëveshjes politike, KQZ është përballur me një sërë sfidash. Ka disa kontradikta në legjislacionin në fuqi. Në lidhje me pyetjen tuaj, dimë që ka ankesa nga partitë politike. Ne po e ndjekim këtë proces dhe ne do të vlerësojmë mbarëvajtjen e



Detajet

PRESIONET

"Ne jemi në fushatë, ndaj të folurit për këtë presion, nuk është në mandatin tonë. Ne duam të kuptojmë dhe të krijojmë një panoramë të plotë mbi çfarë është e vërtetë dhe çfarë nuk është e vërtetë"

QETËSIA

"E vetmja gjë që ne shpresojmë është që dita e zgjedhjeve të jetë e qetë dhe më e rëndësishmja është që votimi dhe zgjedhjet të kryhen në një mjedis të qetë"

e fushatës për zgjedhjet e 25 qershorit?

Mesa duket, fushata ka marrë vull, ndonëse pati një fillim të ngadalë. Ne po ndjekim tubimet elektorale. Ndërkohë që partitë politike po prezantojnë këndvështrimet e tyre.

Kur jumbërritët në Shqipëri data e zgjedhjeve ishte një tjetër, si ju duk kjo manovër për ta ndryshuar atë?

Ndikimi i parë është që ne do të qëndrojmë një javë më shumë në këtë vend. Por, sic e thatë ju, kjo ishte një rezultat i një marrëveshje politike që pati ndikim edhe në disa çështje të tjera. Ne tani po monitorojmë procesin, dhe mënyrën se si po zhvillohet si rezultat i marrëveshjes së arritur.

Si e shikon OSBE-ODIHR ndarjen e komisioneve të grupeve të numërimit midis LSI - PDIU, një parti që në zgjedhjet e kaluara figuronte si opozitë?

Më lejoni të them që si rezultat i marrëveshjes politike, KQZ është përballur me një sërë sfidash. Ka disa kontradikta në legjislacionin në fuqi. Në lidhje me pyetjen tuaj, dimë që ka ankesa nga partitë politike. Ne po e ndjekim këtë proces dhe ne do të vlerësojmë mbarëvajtjen e



Peter Tejler

tij. Procesi është në vazhdim dhe do ta ndjekim nga afër.

A ndan të njëjtin mendim OSBE-ODIHR si KQZ se presioni mbi administratën po shkakton problem me trajnimin e komisioneveve?

Së pari, më lejoni të them që ODIHR është i pavarur dhe i ndarë nga prezenca e OSBE-së këtu në vend. Kjo është e rëndësishme. Nuk ka asnjë lidhje mes këtij misioni dhe prezencës së OSBE-së. Ajo që kemi vënë re është që si rezultat i marrëveshjes politike, një sërë institucionesh siç është edhe KQZ-ja janë përballur me sfida të ndryshme. Ne kemi vënë re që KQZ tha në një deklaratë dhe e bëri shumë të qartë problemin me gjetjen e njerëzve që duhen angazhuar në qendrat e votimit.

Pushimet nga puna në administratë, a janë një formë presioni ndaj votuesve të caktuar?

Sic e dini edhe ju, ne kemi një numër të caktuar vëzhgues afatgjatë të angazhuar në vend.

Ne po e ndjekim situatën edhe prej këndej. Kemi informata për presione të ndryshme. Dimë që ka institucione që po i ndjekin me kujdes këto pretendime qofshin të drejta apo të gabuara. Është shumë e rëndësishme që ne të kemi një panoramë të plotë përpara se të bëjmë një vlerësim.

Ky është proces i vazhdueshëm. Ka institucione shtetërore që po merren me këtë çështje. Gjithashtu ka mënyra të tjera për njerëzit që duan të adresojnë këtë çështje apo të dorëzojnë ankesat e

tyre. Ne po i ndjekim këto nga afër.

Kush po e bën këtë presion?

Kush po bën presion. Ne jemi në fushatë, ndaj të folurit për këtë presion, nuk është në mandatin tonë. Ne duam të kuptojmë dhe të krijojmë një panoramë të plotë mbi çfarë

është e vërtetë dhe çfarë nuk është e vërtetë dhe sigurisht se si sistemi trajton këto pretendime, informacione dhe ankesa. Në ditën pas zgjedhjeve ne do të publikojmë një deklaratë për gjetjet paraprake së bashku me delegacionin parlamentar, dhe këtë çështje mund ta trajtojmë atëherë.

Është e rëndësishme të kuptohet se ne po ndjekim procesin dhe kjo është arsyeja përse ne ndodhemi në vend për një periudhë të gjatë. Ky proces po ndodh tani dhe ne po e ndjekim si dhe shqyrtimin e ankesave.

Retorika e përdorur gjatë kësaj fushate mund të nxisë dhunën ditën e votimit dhe numërimit?

Sigurisht që gjuha politike në këtë vend është e ndryshme. Por nuk mendoj se luan një rol kaq të madh. Ka ndodhur në disa fushata. E vetmja gjë që ne shpresojmë është që dita e zgjedhjeve të jetë e qetë dhe më e rëndësishmja është që votimi dhe zgjedhjet të kryhen në një mjedis të qetë.

Udhëtimet falas për votuesit shqiptarë që jetojnë jashtë? A janë një formë shitblerje vote?

Ne kemi vënë re, nëpërmjet vëzhguesve afatgjatë që po bëhen oferta të tilla mbi transportin. Nuk i dimë rrethanat e plota. Ne po e ndjekim këtë situatë. Ka pretendime në media për këto oferta. Ne po e ndjekim me kujdes çështjen e ofertave për të krijuar një panoramë të plotë të asaj që po ndodh.

United Nations Development Programme

TENDER ANNOUNCEMENT

Subject: Request for Proposal for "RFP for identification and analysis of crafts related enterprises in Albania".

The United Nations Development Programme in Albania is seeking to receive proposals from interested companies who wish to be considered for the above-mentioned service.

Companies will be selected in accordance with established UNDP procedures. The proposal must be delivered within the deadline set in a sealed envelope, clearly marked **UNDP/RFP/2017-38470 "RFP for identification and analysis of crafts related enterprises in Albania"**.

For more details, please refer to the link below:

http://procurement-notices.undp.org/view_notice.cfm?notice_id=38470

Relevant dates: All interested entities should provide their proposal, not later than **30 June 2017**, to the address:

**United Nations Development Programme
"Skenderbej" Street, Gurten Center, 2nd Floor,
Tirana, Albania
UNDP Procurement team**





Seanca

Parlamenti Shqiptar do të mbledhet sot për të miratuar anëtarët e Kolegjit të Apelimit, i cili njihet ndryshe si gjykata e shkallës së dytë e Vetingut, që do të vendosë për fatin e prokurorëve dhe gjyqtarëve

Nis Vetingu, 800 gjyqtarë dhe prokurorë nën hetim

Parlamenti seancë të jashtëzakonshme për miratimin e anëtarëve të Vetingut



ADRIATIK DOÇI
TIRANE

Fundi i gjyqtarëve dhe prokurorëve të korruptuar është më afër se kurrë më parë. Pas tre vitesh betejë epike me segmente të politikë dhe gjyqësorit, falë këmbënguljes dhe investimit historik të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimit Evropian, reforma në drejtësi po merr trajtë përfundimtare. Nën presionin e fortë të Perëndimit, organet e Kuvendit janë vënë në lëvizje për të ngritur dy shtyllat e reformës në drejtësi: Organet e Vetingut dhe Këshillin e Lartë Gjyqësor, i cili do të zëvendësojë Këshillin e Lartë të Drejtësisë. Parlamenti Shqiptar do të mbledhet sot për të miratuar anëtarët e Kolegjit të Apelimit, i cili njihet ndryshe si gjykata e shkallës së dytë e Vetingut, që do të vendosë për fatin e prokurorëve dhe gjyqtarëve. Votimi i sotëm pritet t'i hapë zyrtarisht rrugë zbatimit të Vetingut, pra skanimit të trefishtë të gjyqtarëve dhe prokurorëve për ligjshmërinë e pasurive, lidhjet me krimin dhe aftësitë profesionale. Votimi i sotëm i hap rrugë edhe ngritjes së institucioneve të reja anti-korrupsion: Byrosë Kombëtare të Hetimit, Prokurorisë së Posaçme dhe Gjykatës Speciale.

800 GJYQTARË DHE PROKURORË NËN HETIM

Ngritja e organeve të Vetingut vendos automatikisht nën hetim të trefishtë njerëzit e drejtësisë aktuale. Me zbatimin e Vetingut 800 gjyqtarë dhe prokurorë do të shkarkohen, ndërsa për t'u bërë pjesë e drejtësisë së re, duhet të kalojnë kontrollin për pasuritë, lidhjet me krimin dhe aftësitë profesionale. Testi më i rëndësishëm, i cili pritet të përjashtojë nga sistemi shumë gjyqtarë dhe prokurorë, është verifikimi



Faksimile e urdhërit për mbledhjen e parlamentit

i ligjshmërisë së pasurive të deklaruarasi dhe identifikimi i pasurive të fshehura. Tre do të jenë faktorët të cilët do të hetojnë pasurinë. Hetimi fillestar dhe kryesor bëhet nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive. Duke iu referuar edhe afateve të parashikuara në ligjin e Vetingut, ILDKP mësohet se i ka përgatitur

dosjet e para të pasurive, shoqëruar edhe me rekomandimin përkatës. Dosjet do t'i kalojnë Komisionit të Vlerësimit të Vetingut. Ky i fundit, i asistuar nga Njësia e Shërbimit Ligjor, e përbërë nga këshilltarë ligjorë dhe ekonomikë, do të verifikojë dosjet e referuara nga ILDKP. Gjatë hetimit administrativ, anëtarët e Komisionit mund

AKSESI I VEZHguesVE NDERKOMBETAR

- Në të dhënat mbi pasuritë e paluajtshme të subjektit të rivlerësimit.
- Në llogaritë bankare, të dhënat tatimore, bazat e të dhënave mbi automjetet, të dhënat për hyrjedaljet në kufi.
- Në të dhënat mbi të drejta ose interesa pasurorë të çdo lloji mbi një aset, qoftë ky i luajtshëm ose i paluajtshëm.
- Në të dhënat që provojnë ekzistencën e parave fizike ose mjeteve ose instrumenteve të tjera të tregut të parasë.
- Në të dhënat mbi kreditë, çeqet e udhëtimit, çeqet bankare, urdhërpagesat, të gjitha llojet e titujve, mandatpagesat dhe letrat e kreditit etj.
- Në dokumentet për gjendjen gjyqësore të subjekteve të rivlerësimit.
- Në dosjet personale të subjekteve të rivlerësimit, të dhënat statistikore, dokumentet Ligjore etj.
- Të dhënat që provojnë ekzistencën e trusteve ose marrëveshjeve të tjera të ngjashme.
- Në sistemet e informacionit apo bazat e të dhënave të administruara nga organet shtetërore.
- Në raportimet e Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit dhe Pastrimit të Parave.
- Në denoncimet e punonjësve të Policisë së Shtetit.
- Në dosjet dhe kërkesat e shteteve të tjerë për të bërë hetime të posaçme për çështje Penale.

të kërkojnë informacione shtesë nga çdo institucion publik brenda vendit, por edhe nga shtetet e tjera.

ROLI I EKSPERTËVE TË SHBA-BE

Gjatë procesit të rivlerësimit, sidomos verifikimit të ligjshmërisë së pasurisë, një rol të rëndësishëm do të kenë ekspertët e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimit Evropian, pjesë e Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit. Vëzhguesit ndërkombëtarë, të cilët do të emërohen nga ONM në

radhët e prokurorëve dhe gjyqtarëve të huaj, do të hetojnë dhe vlerësojnë të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit të prokurorëve dhe gjyqtarëve. Gjithashtu, sipas nenit 45 pika 2 të ligjit të Vetingut, gjatë hetimit, vëzhguesi ndërkombëtar mund të kërkojnë informacion nga çdo subjekt i së drejtës publike. Ata kanë të drejtë të administrojnë dokumentet që vërtetojnë veprime, fakte, cilësi ose një situatë subjektive të nevojshme për realizimin e hetimit. Ligji për

Vetingun, në pikën 3 të nenit 33, parashikon gjithashtu që ILDKPKI-ja mundëson akses të plotë për vëzhguesit ndërkombëtarë, që të kërkojnë informacione, të konsultojnë, të kopjojnë dhe të hetojnë deklaratimet e pasurive të paraqitura të prokurorëve dhe gjyqtarëve ose personat e lidhur me të, si dhe çdo dokument shtetëror. Vëzhguesi ndërkombëtarë kanë po ashtu të drejtë të kërkojnë që Komisioni ose Kolegji i Apelimit të marrë në shqyrtim prova ose të paraqesë prova të marra nga organet shtetërore, entitetet e huaja ose personat privatë, pro ose kundër gjyqtarëve dhe prokurorëve. Vëzhguesit ndërkombëtarë kanë të drejtë të marrin të gjithë informacionet menjëherë, të dhënat për persona dhe dokumentet e nevojshme, me qëllim monitorimin e procesit të rivlerësimit në të gjitha nivelet dhe fazat. Ndërkaq, refuzimi i gjetjes së përfaqësuesve të SHBA-BE bëhet vetëm me vendim të arsyetuar të Komisionit ose të Kolegjit të Apelimit.

DOKUMENTET E TJERA

Ekspertët do të kenë gjithashtu akses në llogaritë bankare të gjyqtarëve dhe prokurorëve, në të dhënat tatimore, në bazat e të dhënave mbi automjetet, në të dhënat për hyrjedaljet në kufi etj. Do të kenë akses në të dhënat mbi të drejta ose interesa pasurorë të çdo lloji mbi një aset, në instrumente të tilla si kreditë, çeqet e udhëtimit, çeqet bankare, urdhërpagesat, të gjitha llojet e titujve, mandatpagesat dhe letrat e kreditit, si dhe çdo interes, dividend, e ardhur ose vlerë tjetër që buron prej tyre. Ekspertët do të marrin në dorë të dhënat mbi marrëdhënie të mundshme biznesi të gjyqtarëve dhe prokurorëve, të dhënat që provojnë ekzistencën e parave fizike ose mjeteve ose instrumenteve të tjera, ku përfshihen, çeqet, dëftesat, certifikatat e depozitave, kartat e debitit ose të kreditit, kartat elektronike të pagesave, titujt, si dhe çdo dokument tjetër.

Lu mbështet katër gazetarët të paditur nga Gjini Gjoni

Donald Lu me gazetarët: Beteja juaj është beteja jonë

Katër gazetarët e shtypit të shkruar në Shqipëri, të paditur në gjykatën e Tiranës nga anëtari i KLD, njëherësh dhe gjyqtari i Gjykatës së Apelit, Gjini Gjoni, kanë marrë mbështetjen nga numri një i ambasadës Amerikane në Tiranë, z. Donald Lu. Ambasadori i SHBA, gjatë takimit me katër gazetarët Elton Qyno, Adriatik Doçi të gazetës "Shqiptarja.com" dhe Besart Likmeta e Aleksandra Bogdani të rrjetit ballkanik investigativ BIRN, e vuri theksin tek rëndësia e lirisë së medias në Shqipëri. Njëherësh z. Lu, shprehu solidaritetin e tij për katër gazetarët, që gjatë dy viteve të fundit kanë qenë mjaft aktivë në shkrime të thelluara në lidhje me pasurinë e gjyqtarëve në Shqipëri. Katër gazetarët e mësipërm po përballen në Gjykatën e Tiranës me një padi civile të iniciuar nga gjyqtari i apelit dhe anëtari i KLD-së Gjini Gjoni, i cili kërkon si dëmshpërblim një vlerë monetare prej 82.000 euro, duke pretenduar se me shkrimet e tyre gazetarët i kanë prishur imazhin dhe cenuar personalitetin.

AMBASADA E SHBA

Ambasada e SHBA në profilin e saj në Facebook ka publikuar foton nga takimi me diçiturën: "Beteja juaj është beteja jonë". Ambasadori Lu, ka dashur të jetë shumë i qartë në mbështetjen e tij dhe të SHBA për betejën gjyqësore të katër gazetarëve. Foton e shoqëron edhe me hashtagun "Nuk Do Hiqja Asnjë Presje", shprehje e përdorur nga postimi në rrjetin "Facebook", i gazetarit Adriatik Doçi, kur mësoi se ishte paditur nga Gjini Gjoni. Gazetari shprehej në postim se pavarësisht padisë, nuk do t'i hiqte asnjë presje shkrimeve të tij për Gjini Gjoni.

SEANCA E PARË

Dy ditë më parë në gjykatën e kryeqytetit u zhvillua përballja e parë mes gazetarëve Elton Qyno, Adriatik Doçi, Shqiptarja.com dhe gjyqtarit Gjini Gjoni. Gjyqtarja e seancës Blerina Muça në Gjykatën e Tiranës vendosi të pezullojë përkohësisht padinë civile të gjyqtarit Gjini Gjoni, për shkak se shqyrtimi i padisë së Gjinit sipas gjyqtarës është në konflikt interesi. Gjoni nuk ishte i pranishëm, por u përfaqësua nga avokati i tij Ledio Braho. Procesi gjyqësor u zhvillua në ambientet e zyrës së gjyqtarës Muça, ndërkohë kjo e fundit në fillim të seancës së parë gjyqësore rrëzoi kërkesën e gazetarit Elton Qyno, për lejimin e kamerave që të regjistrin procesin gjyqësor. Teksa ka bërë njohjen me palët në seancë gjyqësore, gjyqtarja Muça vendosi që me anë të një shkresë të kërkojë nga kryetarja e gjykatës së Tiranës Enkelejdi Hajro, të



NË FOTO:
(Lart) Gjyqtari Gjini Gjoni (Djathtas) Ambasadori Donald Lu dhe gazetarët Elton Qyno, Adriatik Doçi, Besart Likmeta e Aleksandra Bogdani



vërë në lëvizje Këshillin e Lartë të Drejtësisë për transferimin e një gjyqtari, që do ishte jashtë konfliktit të interesit. Gjyqtarja tha se për

shkak se njëri nga paditësit, Gjini Gjoni, është gjyqtar në Gjykatën e Apelit Tiranë dhe ish-gjyqtar i Gjykatës së Tiranës e ish-koleg i gjyqtarës,

ajo nuk mund të gjykonte çështjen. Ky proces, deri në një vendimarrje nga kreu i gjykatës së Tiranës dhe KLD do të mbetet pezull, ndërsa

gjyqtari i apelit Gjini Gjoni njëherazi paditës në këtë proces prej 2013 është dhe anëtari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Rrjedhimisht Gjini Gjoni duhet të japë dorëheqjen dhe të zhvishet nga funksioni i tij si anëtar i KLD, institucion ky, ku do diskutohet kërkesa e gjyqtarës Blerina Muça, për kaktimin nga KLD të një gjyqtari të ri, për gjykimin e padisë civile mes çiftit të bashkëshortëve Gjoni, gazetës "Shqiptarja.com" dhe dy gazetarëve të saj Elton Qyno dhe Adriatik Doçi.

VENDIMI I GJYKATËS

Vendimi i gjykatës së Tiranës, erdhi në një kohë kur dhe Unioni i Gazetarëve Shqiptarë i mbështetur nga ambasada e SHBA, i kërkoj Gjini Gjoni që të zhvishet nga funksionet e larta drejtuese dhe të krijojë një mundësi të barazisë së tij me gazetarët si palë e akuzuar. "UGSH, duke mbetur në pritje të seancave dhe gjyqësorëve të pritshme, pa nisur ende ato, në emër të parimit të mos ndikimit për shkak të pozitës dhe për të evituar çdo nuancë intimidimi prej zotit Gjini Gjoni, i kërkon atij dorëheqjen nga funksionet e larta drejtuese, duke e konsideruar këtë një mundësi të barazisë së tij me gazetarët si palë e akuzuar, në raport me proceset gjyqësore që ai ka hapur"- thuhet në deklaratën e Unionit të Gazetarëve të Shqipërisë. Gazeta Shqiptarja.com dhe gazetarët Elton Qyno e Adriatik Doçi janë thirrur nga paditësit Gjoni dhe Elona Çausi me pretendimin se raportimet e tyre mbi pasurinë e familjes në fjalë dhe mbi hetimet prokurorisë e vendimet gjyqësore mbi këtë pasuri nën dyshimet për "falsifikim dokumenti" dhe "Fshehje të ardhurash" përbëjnë cënim të

Mbështetja

Katër gazetarët e shtypit të shkruar në Shqipëri, të paditur në gjykatën e Tiranës nga anëtari i KLD, njëherësh dhe gjyqtari i Gjykatës së Apelit, Gjini Gjoni, kanë marrë mbështetjen nga numri një i ambasadës Amerikane në Tiranë, z. Donald Lu



Ambasada

Ambasada e SHBA në profilin e saj në Facebook ka publikuar foton nga takimi me diçiturën: "Beteja juaj është beteja jonë". Ambasadori Lu, ka dashur të jetë shumë i qartë në mbështetjen e tij dhe të SHBA për betejën gjyqësore të katër gazetarëve

nderit dhe personalitetit. Çifti Gjoni-Çausi pretendojnë se kanë pësuar dëm jo pasuror nga raportimet sipas tyre të pavërteta dhe kërkojnë dëmshpërblim 2 milionë lekë nga gazeta dhe nga 1 milionë nga secili prej gazetarëve Qyno dhe Doçi. Në një çështje të veçantë, bashkëshortët Gjoni dhe Çausi kanë ngritur padi edhe ndaj Rrjetit Ballkanik të Gazetarisë Investigative, BIRN Albania dhe gazetarëve Besar Likmeta e Aleksandra Bogdani me pretendimet se raportimet i kanë shkaktuar vuajtje shpirtërore. Gjoni dhe Çausi kërkojnë dëmshpërblim për dëm jopasuror në masën 5 milionë lekë nga BIRN dhe nga 1 milionë lekë nga secili prej gazetarëve.



The United Nations High Commissioner for Refugees Representation in Albania invites for sealed Expression of Interest Proposals as stated in the document below:

CALL FOR EXPRESSION OF INTEREST No. UNHCR/Albania/2017/002

"Promoting co-existence and economic empowerment of UNHCR persons of concern residing in Albania"

Necessary documents in English, may be obtained at the UNHCR Office at the address: UNHCR, UN House, Skënderbej Street, Gurten (Volkswagen) Building, 2nd floor, Tirana, Albania. Please note that deadline for submission of proposals is **12 July 2017**.

The same set of documents in English, can also be found at UN web site: www.un.org.al at the section "Employment and Procurement".

“Rusët po blejnë media në Shqipëri” Ja si gazetaret ranë në grackë


Shqiptarja.com ka kontaktuar autorin e shkrimit të supozuar Mark Gjonaj dhe zbulon të vërtetën: Ai artikull është i fabrikuar, nuk e kam shkruar unë

KLAUDJA KARABOLLI
TIRANË

Një vëzhgim i Shqiptarja.com tregon se Fake News po bëhet një gabim viral i mediave online. Askush nuk mban përgjegjësi për tekstet që shkruhen dhe shpërndahen pa burime dhe pa fakte. Jeta e vrullshme në një redaksi lajmesh kërkon që herë pas here të shkëputemi për të diskutuar për lajme, tituj, gabime, tema dhe çështje që lidhen me gazetarinë, kryesisht për vërtetësinë e trafikut të informacionit. Kështu ndodhi herën e fundit, “Rusia ka blerë një televizion dhe tre portale në Tiranë” ishte titulli që na bëri kureshtar të gjithëve. Teksti i lajmit fliste për një deklaratë të bujshme të Mark Gjonaj, Asembleist në Asamblesë e New Yorkut. Sipas medias në fjalë, Shqipëria është pjesë e një projekti të quajtur “NEW-Alb-Transfert Media Contract”, që synon të ndikojë opinione publike përmes blerjes dhe përdorimit të medias. Teksti tingëlloi alarmant në redaksinë tonë! Një shkrim pa burime dhe një projekt pa fakte që përdor veç një emër e mbiemër për tu dukur i besueshëm tek audienca, që shpesh janë edhe vetë gazetaret. Linku i lajmit kaloi menjëherë tek të gjithë. Nga kërkimi në Google rezultoi se ky lajm ishte në shumë portale të tjera. Vallë Shqiptarja.com kishte humbur lajmin e ditës? Në pesë portale të ndryshme lajmi kishte vetëm një burim, emrin Mark Gjonaj, personi që supozohej se ka bërë deklaratën. Telefonatat mes miqsh gazetarë nuk m'i shuan pikëpyetjet që kisha në kokë. Lehtësitë teknologjike nuk prodhojnë përmbajtje, por rrisin cilësinë e saj, gjithmonë kur përdoren zgjuar. Dërgova një email në adresën zyrtare të Këshilltarit Mark Gjonaj (GjonajM@nyassembly.gov), ku si gaze-

tare shtrova të gjitha pyetjet e mia rreth deklaratës që qarkullonte në media. Përgjigjia zyrtare erdhi shpejt. Asambleisti Mark Gjonaj mohoi deklaratën që është shpërndarë në portale dhe më kërkoi të fshija menjëherë një artikull të tillë. “Po ju shkruaj në lidhje me një artikull të botuar ditëve të fundit në portale të ndryshme: “Rusia ka blerë një televizion në Shqipëri dhe tre portale, së shpejti edhe një gazetë” me 14 Qershor, 2017 ku identifikohem si Asambleist i Shtetit të Neë Yorkut. Dua të bej të ditur publikisht dhe kategorikisht se as unë dhe as dikush në emrin tim, nga zyra

ime e Asamblesë apo e Fushatës, nuk ka shkruar një artikull të tillë, nuk ka dhënë intervistë dhe as ka komentuar në lidhje me këtë çështje.” U lehtësova shumë. Mes falenderimësh për përgjigjen e shpejtë i tregova zotit Gjonaj, se në median ku punoj, ky artikull nuk është botuar. Shqiptarja.com nuk e humbi lajmin, gazetaria bëri diferencën. Mjafton kaq pak, një komunikim, një telefonatë apo një mesazh për të mos rënë në grackën e Fake News. Nëse diskutohet a na duhet më gazetari, vorbulla e fake News është prova që bota ka nevojë për frymëmarrjen e gazetarit të vërtetë.



Faksimile e emailit të përgjigjes së Mark Gjonaj për Shqiptarja.com

Mark Gjonaj
Bronx, NY, 10461
15 Qershor, 2017

Drejtuar Editoreve/Botuesve dhe gazetarëve:

Po ju shkruaj në lidhje me një artikull të botuar ditëve të fundit në portale të ndryshme: “Rusia ka blerë një televizion në Shqipëri dhe tre portale, së shpejti edhe një gazetë” me 14 Qershor, 2017 ku identifikohem si Asambleist i Shtetit të Neë Yorkut.

Dua të bej të ditur publikisht dhe kategorikisht se as unë dhe as dikush në emrin tim, nga zyra ime e Asamblesë apo e Fushatës, nuk ka shkruar një artikull të tillë, nuk ka dhënë intervistë dhe as ka komentuar në lidhje me këtë çështje.

Si rrjedhojë, kërkoj që menjëherë ky artikull i fabrikuar të hiqet nga faqja juaj në internet dhe të ndalohet shpërndarja dhe i ketre lajmeve të fabrikuar dhe të rrenë dhe gjithashtu kërkoj që të botoni një përgjigje të ketre deklaratave.

Ju lutem konfirmimi që e keni marrë këtë korrespondencë dhe kërkoj reagimin tuaj të shpejtë dhe konfirmimin tuaj që do të veprimi në përputhshmëri me kërkesat që ju janë bërë në këtë email.

Sinqerisht,
Mark Gjonaj
Asambleist i Shtetit të Neë Yorkut.

Ja teksti i lajmit fals

Kohët e fundit kemi lexuar shumë artikujt nga media ndërkombëtare prestigjioze për rritjen e prezencës së Rusisë në Ballkanin Perëndimor dhe shpesh herë kemi parë reagime të ndryshme për vërtetësinë apo të këtyre lajmeve. Mirëpo një studim i Qendrës së Studimeve Gjeopolitike Ndërkombëtare dhe shkrimit të profesorit amerikan Dev Injatus del në pah se Shërbimet sekrete ruse (SVR) dhe shërbimi i Ushtrisë (GRU) kanë ndërtuar strategji të sofistikuara të luftës media-

tike. Përmendet në studim jo pa rëndësi projekti i ashtuquajtur “NEW-Alb-TransfertMedia Contract”, për të ndikuar në opinione publike përmes blerjes dhe përdorimit të mediave. Kanale mediatike jo dhe aq periferike janë ofruar të transmetojnë dhe në të gjithë Shqipërinë, kundrejt pagesave apo shitjes 100% të aksioneve, të produkteve televizive ruse apo sllave. Flasin për shifra që shkojnë nga 1 euro në 1 milion e 400 mijë euro. Shuma e përcaktuar në kontratë për të përfshijë edhe

implementin e procedurave për kalimin e pronësisë edhe të 1 gazete shqiptar tirazh jo të vogël si dhe të 3 portaleve elektronike. Me qëllim konkludimin e marrëveshjes së nënshkruar kanë mbërritur në Tiranë nga Moskë biznesmenë, gazetarë, analistë, studiues dhe diplomatë, që fare mirë mund të jenë punonjës së shtetit rus, të cilët kanë vizituar ambientet e këtij televizioni kanë diskutuar për instalimin e aparaturave të reja Satelitore për transmetim në H-D.

SHKRIMI I PARË (13 QERSHOR 2017-10:43)

Faqja maqedonase "Zurnal.mk" ku rezultojn se është publikuar për herë të parë opinioni

Elitat politikeshqiptare, sado pa experience qofshin, e dine mire këtë fakt se komedias demton rëndë imazhin e profesionistëve, gazetarëve, studiuesve dhe të vete Shqipërisë.

13.06.2017, 10:43 | Z.H. | 1,711 | lexuar

SHKRIMI I DYTË (13 QERSHOR 2017-10:43)

Pse Rusia kërkon Tetova Sot - 13-Jun-2017
Publikuar: 12:00, 13 Qershor 2017
ndërkombëtare prestigjioze për reagime ...

SHKRIMI I TRETË (13 QERSHOR 2017-10:43)

Pse Rusia kërkon Ina-Online - 14-Jun-2017
Mark Gjonaj* Kohët e fundit
prezencës së Rusisë në Tiranë
apo të ...

SHKRIMI I KATËR (13 QERSHOR 2017-10:43)

Shkrimi i publikuar në gazetën "Dita" print dhe faksimile nga versioni online

Pse Rusia kërkon të ndikojë rajonin duke blerë media
www.gazetadita.al/pse-rusia-ka-ble-nyje-televizion-dhe-tre-portale-ne-tirane
2 dite më parë - Nga Mark Gjonaj
prestigjioze për rritjen e prezencës së Rusisë në Tiranë

SHKRIMI I PESTË (13 QERSHOR 2017-10:43)

NË FOTO:
Mark Gjonaj,
Asembleist në Asamblesë e New Yorkut

13 QERSHOR 2017 - 12:02

n të ndikojë rajonin duke blerë media... 7 12:03... shor, 2017 Mark Gjonaj * Kohët e fundit kemi lexuar shumë artikujt nga media... oze për rritjen e prezencës së Rusisë në Ballkanin Perëndimor dhe shpesh herë kemi

Faqja maqedonase "TetovaSot" ku u publikua opinioni në 13 qershor dhe është fshirë një ditë më pas

(14 QERSHOR 2017 - 02:21)

n të ndikojë rajonin duke blerë media... 02:21... dit kemi lexuar shumë artikujt nga media ndërkombëtare prestigjioze për rritjen e Ballkanin Perëndimor dhe shpesh herë kemi parë reagime të ndryshme për vërtetësinë

Faqja maqedonase "Ina-online" ku u publikua opinioni pas mesnatës së 13 qershorit dhe u fshi pas disa orës

(14 QERSHOR 2017)



QERSHOR -11:49

"Tema-online" dhe "27.al" që kanë publikuar opinionin në 15 qershor

një televizion dhe tre... Nga Mark Gjonaj* Kohët e fundit kemi lexuar shumë artikujt nga media ndërkombëtare prestigjioze për rritjen e pranisë së Rusisë në Ballkanin Perëndimor dhe shpesh herë kemi parë reagime të ndryshme për vërtetësinë apo të këtyre lajmeve. Mirëpo një studim i Qendrës së Studimeve Gjeopolitike Nderkombëtare dhe shkrimi të profesorit amerikan Dev Injatus del në pah se shërbimet sekrete ruse (SVR) dhe shërbimi i Ushtrisë

SHKRIMI I GJASHTË (15 QERSHOR)



Lajmi i rremë u prodhuan në Maqedoni dhe u kopjua nga mediat në Tiranë

Shqiptarja.com ka ndjekur "rrugën" e Fake News mbi rusët, nga "Zhurnal.mk" deri tek gazeta "Dita"

ANTONIO ÇAKSHIRI
TIRANE

Rusia kërkon të ndikojë rajonin duke blerë media", titulli që pushtoi mediat maqedonase dhe më pas ato shqiptare, është opinioni i supozuar i Mark Gjonajt ku thuhet se Rusia kishte blerë një gazetë shqiptare, një televizion dhe tre portale elektronike. Këshilltari në Asambleen e New York-ut Mark Gjonaj i kontaktuar nga "Shqiptarja.com" deklaroi se nuk ishte ai autor i shkrimit të shpërndarë gjatë ditëve të fundit nga mediat e shtetit fqinj dhe më pas ato vendase. Një "Fake-News" që e arriti qëllim duke u publikuar në shumë media, disa prej të cilave serioze.

PUBLIKIMI I PARË


Nga kërkimet e kryera nga "Shqiptarja.com" pas vërtetimit se ky lajm nuk është i vërtet rezultatun se burimi i parë i shkrimit është një media maqedonase, shteti i cilësuar si magazina e lajmeve të rreme nga mediat e huaja, pasi nuk është hera e parë që gazeta të Maqedonisë publikojnë lajme të rreme që fatkeqësisht gjejnë përhapje të gjerë edhe në Shqipëri.

MAQEDONIA

Nga kërkimet rezultojnë se Zhurnal.mk ka publikuar opinion në 13 Qershor 2017 në orën 10:43 dhe i lexuar mbi 1700 herë në portalin maqedonas, më pas shkrimi është publikuar nga dy media maqedonase, përkatësisht "Tetova Sot" në 13 Qershor 2017 në orën 12:03 dhe "Ina-Online" në 02:21 të mëngjesit të 14 Qershorit. Por në këto dy media shkrimi është fshirë nga portali një ditë më vonë.

SHQIPËRIA

Opinionin i rremë gjeti shtrirje të gjerë në faqet shqiptare një ditë pas publikimit nga mediat maqedonase. Media e parë në vendin tonë që publikoi opinionin e supozuar të Mark Gjonajt ishte "Gazeta Dita" ku shkrimi ishte botuar në një nga faqet e gazetës



Reagimi i ambasadës Ruse në Tiranë për shkrimin e publikuar nga disa media shqiptare online dhe gazeta "Dita" në print

TIMELINE I PERHAPJES SE LAJMIT MBI NDIKIMIN RUS NE SHQIPËRI

MAQEDONI

- 13 Qershor 2017 në ora 10:43 – Botimi i parë i opinionit në portalin maqedonas Zhurnal.mk
- 13 Qershor 2017 në ora 12:03 – botimi në "Tetova Sot", opinionin fshihet disa orë pas publikimit.
- 14 Qershor 2017 në ora 02:21 e mëngjesit botimi tek "Ina-Online", opinionin u fshih edhe nga ky portal disa orë pas publikimit

SHQIPËRI

- Gazeta Dita (print dhe online) 14 Qershor 2017
- Botimi në disa portale me media të tjera shqiptare gjatë paradites së 14 Qershorit
- Reagimi i Ambasadës Ruse për opinionin rreth orës 18:00 në 14 Qershor.
- Opinioni publikohet në 15 qershor nga Gazeta Tema, 27.al dhe portale të tjera.

së datës 14 Qershor dhe i publikuar edhe në portalin online të gazetës. Paraditen e 14 Qershorit dhe 15 qershorit

opinionin pa u verifikuar është shpërndarë më pas në shumë media dhe portale të tjera shqiptare, mes tyre Gazeta

Të huajt
Maqedonia,
magazina e
"Fake-News"

Në disa dokumentare realizuar nga mediat e huaja mes tyre BBC, një qytet i vogël në Maqedonas, Velezi është cilësuar si magazina e prodhimit të lajmeve të rreme "Fake-News" gjatë fushatës së zgjedhjeve presidenciale në SHBA, nga ku më pas janë përhapur në mediat ndërkombëtare. Disa të rinjtë të këtij qyteti në Maqedoni me anë të aftësive të tyre kanë arritur të fusin në "kurth" mediat me shkrime të pavërteta, por në dukje reale.

Tema online dhe 27.al.


REAGIMI I AMBASADËS RUSE NË TIRANË

Pasditën e 14 Qershorit Ambasada Ruse në Tiranë përmes një komunikate për mediat ka përgënjeshtruar shkrimin e përhapur nga mediat shqiptare, mes tyre Gazeta Dita. Ambasada ruse e cilësoi opinionin si trillim antirus dhe reagoi ndaj autorit të shkrimit, emri i të cilit fatkeqësisht u keqpërdor për ta bërë opinionin në dukje sa më real.

"COPY-PASTE"

Epoka e një gazetarie dixhitale e ka bërë më të thjeshtë përhapjen e lajmeve të rreme me qëllim manipulimin e opinionit publik, shkrimet që shpesh herë nuk verifikohen nga mediat online dhe hidhen "Copy-Paste" pasi janë publikuar nga gazeta serioze janë ato që mund të jetë edhe totalisht të pavërteta.

Fake News i përsëritur Rasti i ish-Presidentit të Iranit Ahmadinexhad



Vetëm 7 muaj më parë mediat shqiptare ranë pre e një tjetër "Fake-News" të prodhuar nga Maqedonia. Lajmi i ish-Presidentit të Iranit Mahmoud Ahmadinexhad si një çoban që ruante delet, shkrimi i shoqëruar me një foto ku ish-presidenti shfaqej duke mbajtur një shkop majë një kodre. Edhe atëherë "Shqiptarja.com" përgënjeshtror lajmin e mediave maqedonase, mes tyre Zhurnal.mk që ishte ndër të parat që e kishin si lajm. Në të vërtetë ish-presidenti iranian Ahmadinexhad kishte qenë në një fshat malor në një provincë të Iranit, por fotoja e vizitës së tij u keqpërdor nga mediat maqedonase për të krijuar një "Fake-News" që mori shtrirje të gjerë atëherë në portalet online shqiptare.

TRENDI/ RITJA MË E MADHE MË 2016, 9.3% NDAJ 2015-ËS

INSTAT: Eksportet u rritën 4.6 për qind në vit katër vitet e fundit

2012-2016,
gjysma e
importeve, nga
50 ndërmarrje
të mëdha

eksportuese me 7.2%, në 2.740 ndërmarrje në fund të 2016-ës, krahasuar me 2.029 ndërmarrje në vitin 2012.

Kjo rritje, sipas INSTAT-it, ka ardhur kryesisht në vitin 2016, kur ato u rritën me 9.3% krahasuar me vitin e mëparshëm. Industria vijon të ketë peshën më të madhe në eksportet e mallrave duke zënë 84.5% të totalit të eksporteve.

Produktet e industrisë përpunuese zënë pjesën më të madhe të eksporteve (80.4%), konkretisht produktet tekstile, produktet e përpunimit të lëkurës dhe

produktet e metaleve bazë. Pjesën tjetër të eksporteve e zënë produktet nga minierat dhe nxjerrja (15.1%), energjia elektrike (4%) dhe produktet bujqësore (0.7%).

Sa i takon përqëndrimin të eksporteve të mallrave, gjysma e vlerës totale gjatë kësaj periudhe është dhënë nga 20 ndërmarrjet më të mëdha, megjithëse kjo shifër është ulur në 37.3% për vitin 2016.

Nga ana tjetër, edhe importet kanë patur një rritje të lehtë me 1.4%, ndonëse numri i ndërmarrjeve importuese është rritur mesatarisht me 6.2%. Janë bizneset treg-

tare ato që kanë importuar në vlerën më të madhe prej 54.4%. Në industrinë përpunuese, e cila zë 31.9% të importeve, produktet ushqimore zënë mesatarisht 15.4%, produktet e koks dhe nënprodukte të naftës të rafinuara zënë 17.2%.

Gjatë viteve 2012-2016, gjysma e vlerës së importeve është kryer nga 50 ndërmarrjet më të mëdha, por ky përqëndrim është ulur në vitin e fundit. Italia mbetet partneri tregtar kryesor, teksa eksportet e mallrave në sektorin e industrisë drejt tij janë rritur në vlerën 700



milione lekë, nga 500 milionë lekë në vitin 2012.

Gjatë kësaj periudhe Kosova ka zënë vendin e dytë si partner tregtar në eksporte Greqisë, ndërsa rritje kanë shënuar dhe eksportet drejt

Maqedonisë dhe Kinës. Varësia e importeve në sektorin e tregtisë nga Italia është ulur, ashtu sikurse nga Greqia, por është rritur nga partnerët të tjerë si Kina, Turqia dhe Gjermania.

Ja pse plani Basha për ekonominë është i porealizueshëm

Shteti duhet të gjente 1.5 miliardë euro më shumë në vit për të realizuar premtimet ekonomike

DRINI KUQO
TIRANE

Paketa e premtimeve të Lulzim Bashës për ekonominë është thjesht populiste dhe e porealizueshme. Nëse premtimet e tij për uljen e TVSH, për uljen e taksës së kompanive,

të taksës personale dhe barrës së sigurimeve do të mbaheshin, buxheti i shtetit do të pësonte një goditje prej plot 440 milionë eurosh, që në vitin e tij të parë ose rreth 1.7 miliardë euro në katër vjet.

Le t'i analizojmë këto zëra me radhë.

TVSH - Nga mbledhja e TVSH, në financat e shtetit shqiptar u arkëtuan 131.3



Lulzim Basha me qytetarë në takim elektorale

miliardë lekë gjatë vitit të shkuar kur niveli i kësaj takse ishte 20%. Basha premtonte reduktimin e kësaj takse në 15%. Nëse një masë e tillë do të ndërmerrej, shteti do të grumbulonte 32 miliardë lekë më pak në vit.

Taksa për kompanitë - Aktualisht në nivelin e 15%, kontribuoi vitin e shkuar me 28.9 miliardë lekë në arkën e shtetit. Shkurtimi i kësaj takse në nivelin e 9%, do të shkurtojte automatikisht me 12.6 miliardë lekë financat e shtetit.

Taksa personale - Një taksë progresive, rritet gradualisht nga 13% deri në 23%, në funksion të të ardhurave. Sa më të larta të ardhurat, aq më e lartë taksa. Kjo taksë dërgoi në buxhet vitin e shkuar 21.5 miliardë lekë. Premtimi i

Bashës do të ulte nivelin e realizimit të të ardhurave në buxhet me 10 miliardë të mëtejshëm.

Sigurimet shoqërore - Aktualisht, një punonjësi i mbahet 24.5% e pagës për kontribute, nga të cilat 9.5% i paguan punonjësi dhe pjesën tjetër kompania. Plan i Bashës synon një reduktim modest, nga 9.5%, në 9% të barrës së punëtorit. Kjo do të kishte një efekt prej 3.1 miliardë lekësh në buxhetin e shtetit.

Përse është e porealizueshme? E përmbledhur, kostoja e të gjithë paketës do të ishte 57.6 miliardë lekë ose 440 milionë euro më pak në buxhetin e shtetit, një buxhet i varfër që në total mezi tejkalon nivelin e 3 miliardë eurove.

Në bazë të këtij plani,

BUXHETI

Përse është e porealizueshme? E përmbledhur, kostoja e të gjithë paketës do të ishte 57.6 miliardë lekë ose 440 milionë euro më pak në buxhetin e shtetit. Do të ishte një buxhet i varfër, i cili, në total, mezi do të tejkalonte nivelin e 3 miliardë eurove

papritmas, shteti shqiptar do ta gjente veten me shumë më pak të ardhura për investime, për paga, për pensione dhe për pagesën e kësteve të borxhit të marrë ndër vite, por kjo bëhet edhe më e porealizueshme nëse merr parasysh premtimet e tjera të Bashës, për rritjen e pagave të administratës me 50%, rritjen e subvencioneve për bujqësinë, rritjen e investimeve në infrastrukturë, rritjen e pensioneve, etj. një paketë që ka një vlerë prej një miliard eurosh në vit.

Në këto kushte, shteti shqiptar do të duhet të gjente 1.5 miliardë euro më shumë në vit, 500 milionë euro nga rënia e mbledhjes së të ardhurave dhe 1 miliardë më shumë vetëm për të realizuar premtimet ekonomike të Bashës.

Kjo nuk ka asnjë gjasë që të ndodhë, as përmes një rritjeje drastike të borxhit publik gjatë një mandati të mundshëm të Bashës. Për këtë arsye, paketa që PD ofron për ekonominë, në sytë e ekspertëve mbetet plotësisht e porealizueshme.

GREQIA

Shpëton Athina, siguron vazhdimin e kreditimit



Greqia dhe kreditorët arritën të ruanin vazhdimësinë e programit të shpëtimit, ndërkohë që kanë vendosur të shtyjnë vendimin për lehtësimin e borxhit. Gjatë takimit të Eurogrupit në Luksemburg, ministrat e Financës së Eurozonës ranë dakord mbi disbursimin e kredisë prej 8.5 miliardë euro pas plotësimit të kërkesave nga ana e Greqisë për të mbyllur rishikimin e dytë të programit të rënë dakord në 2015-ën. Paratë do të disbursohen nga Mekanizimi i Stabilitetit Europian (ESM), fondi i emergjencave europian. Pjesa e parë prej 6.9 miliardë euro do të përdoren për të ripaguar kreditet e mëparshme në korrik, ndërsa pjesa e dytë prej 800 shteti shqiptar do të duhet të gjente 1.5 miliardë euro më shumë në vit, 500 milionë euro nga rënia e mbledhjes së të ardhurave dhe 1 miliardë më shumë vetëm për të realizuar premtimet ekonomike të Bashës. milionë euro do të mbulojë pastrimin e borxheve nga shteti grek. Pjesa e mbetur prej 800 milionë euro do t'i jepen Greqisë pas verës për të tjera pagesa, me kushtin që Greqia të shtojë disa para shtesë kësaj shume.

DOGANA

Ja vlera e mallrave që nuk duhet kaluar nëpër kufij

Doganat kanë vënë në funksion në të gjithë zyrat doganore e-modulin e të deklarimit të thjeshtuar për të deklaruar mallrat personale që kanë vlerë mbi kufirin e përjashtimit nga detyrimet doganore. Vlera e mallrave që përfitojnë përjashtim (pa përfshirë këtu produktet e duhanit dhe alkoolit) është 300 euro për çdo udhëtar në rrugë tokësore dhe 430 euro për çdo udhëtar në rrugë ajrore ose në rrugë detare. Deklarimi i thjeshtuar nëpërmjet sistemit kompjuterik të doganës do të përdoret vetëm për mallrat personale të natyrës jo-tregtare, të cilat kanë detyrime doganore për të paguar.

VOTONI!!

ËSHTË E DREJTA JUAJ TË ZGJIDHNI!

ZGJEDHJE PËR
KUVENDIN E SHQIPËRISË
25.06.2017

**Dokumentet zyrtare të
vlefshme të identifikimit
për votim janë:**

**Letërnjoftim
ose Pasaportë**

**Qëndrat e votimit
hapen në orën 07:00
dhe mbyllen në
orën 19:00**

**Dhënia e dokumentit të identifikimit shtetasve të tjerë,
apo marrja e dokumentit të identifikimit të shtetasve
të tjerë me qëllim përdorimin e tij
në mënyrë të paligjshme për zgjedhje,
përbën vepër penale dhe dënohet me ligj!**



Për më shumë informacion vizitoni faqen e internetit
të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve: www.cec.org.al

Informohu dhe raportu përmes celularit, shkarko aplikacionin **VOTO 2017**

Raporto në numrin pa pagesë **0800 0803**



Kapen 710 kg drogë po bëhej gati të trafikohet në Itali

Policia arreston të moshuarin Selman Hamitaj. Droga u kap në fshatin Dukat

ELTON QYNO
TIRANE

Operacioni i koduar "Eekends" pikasi, ndoqi dhe më pas e bllokoi në banesën e një 71-vjecari nga fshati Dukat, një furgon plot me kanabis. Nga peshimi i lëndës narkotike, rezultoi se furgoni kishte në brendësi 710 kg kanabis sattiva.

Në pranga ra kryefamiljari Selman Hamitaj, 71 vjeç. Operacioni është kryer gjatë ditës së djeshme nga Drejtoria Vendore e Policisë Vlorë, në bashkëpunim me Drejtorinë Vendore të Policisë Kufitare dhe Migracionit Vlorë. Në bazë të informacioneve të marra në rrugë operative, gjatë natës kanë sinjalizuar një automjet i cili dyshohej se transportonte lëndë narkotike.

Menjëherë, falë një pune hetimore të mire organizuar të këtyre forcave policore, filloi ndjekja dhe bllokimi mjetit tip "Furgon" me targë EL 2494 C, në orët e para të mëngjesit të djeshëm në



Droga e sekuestruar

banesën e shtetasit Selman Hamitaj, në fshatin Dukat, Vlorë.

27 PAKO ME DROGË

Nga kontrolli që i është ushtruar këtij mjeti, brenda

→ NJË NË KËRKIM

Në lidhje me këtë ngjarje, Policia ka arrestuar në flagrancë shtetasin Selman Hamitaj, 71 vjeç, banues në fshatin Dukat, Vlorë, dhe ka shpallur në kërkim shtetasin B.T. 44 vjeç, banues në Durrës.

→ NË BANESË

Falë një pune hetimore të mirë organizuar të këtyre forcave policore, filloi ndjekja dhe bllokimi mjetit tip "Furgon" me targë EL 2494 C, në orët e para të mëngjesit të djeshëm në banesën e shtetasit Selman Hamitaj.

në të është konstatuar një sasi me lëndë narkotike, e cila pas peshimit të përgjithshëm ka rezultuar në total 710 kilogramë, e dyshuar e llojit "Cannabis Sattiva". Lënda narkotike ishte e

ndarë dhe e vendosur në 27 pako të mbështjella me plastikë dhe natriban, si dhe në 8 çanta sportive, të cilat u bllokuan dhe u sekuestruan në cilësinë e provës materiale. Në lidhje me këtë ng-



Furgoni i ku u gjend sasia e drogës

jarje, Policia ka arrestuar në flagrancë shtetasin Selman Hamitaj, 71 vjeç, banues në fshatin Dukat, Vlorë, dhe ka shpallur në kërkim shtetasin B.T. 44 vjeç, banues në Durrës, si autorë të dyshuar në lidhje me këtë ngjarje. Vazhdojnë hetimet për zbulimin dhe kapjen e autorëve të tjerë bashkëpunëtorë të implikuar në këtë veprimtari kriminale.

DO TRAFIKOHEJ NË ITALI

Ka të dhëna policore se sasia prej 710 kg drogë kishte për destinacion tregun Italian të drogës. Personat e arrestuar po mundoheshin ta trafikonin lëndën narkotike

në drejtim të Italisë, ku për kalimin e saj në këtë shtet, do përdorej një skaf. Policia dhe Prokuroria e Krimeve të Rënda janë angazhuar për kryerjen e një sërë veprimesh hetimore me qëllim arrestimin dhe të personave të tjerë, të dyshuar se janë të përfshirë në këtë trafik drogë. Gjatë marjes në pyetje shtetasi Selman Hamitaj nuk ka pranuar të tregojë bashkëpunëtorët dhe pronarët e vërtetë të lëndës narkotike. Pritet që në ditët në vijim ai të dalë para Gjykatës së Krimeve të Rënda për tu njohur me masën e arrestit në burg që do kërkojë përfaqësuesi i prokurorisë.

DROGA ISHTE E NDARË NË 20 PAKO ME LOGO "PLAY BOY"

Bos-i shqiptar i gazit kapet me 20 kg kokainë në Greqi

Një biznesmen shqiptar i naftës dhe gazit si dhe biznesmeni më i njohur në Trikala të Greqisë Thanasis Karatzouni janë arrestuar nga prokuroria e Athinës me akuzën e trafikut të kokainës nga Kolumbia në Europë. Operacioni është finalizuar 1 ditë më parë në Greqi ndërsa ndërsa në momentin e arrestimit dy biznesmenët, shqiptari identiteti i të cilit

ende nuk dihet dhe greku u janë sekuestruar 20 kg kokainë. Droga sipas policisë greke ishte e ndarë në 20 pako me logo "Play Boy" sic dhe shihni në këtë foto çka sipas hetuesve helen tregon cilësinë e lartë të saj e cila arrin në 100 euro gram. Mediat greke raportojnë se operacioni është ende në zhvillim ndërsa identiteti i biznesmenit shqiptar nuk

është publikuar ende. Biznesmeni u arrestua në Larisa në kohën kur po transportonte drogën nga Shqipëria drejt Greqisë. Një biznesmen grek pronar i një kompanie naftë në Shqipëri, mik i një ish-ministri grek u arrestua në Greqi pasi u sekuestruan rreth 20 kilogramë kokainë. Mediat e shtetit fqinj bëjnë me dije se së bashku me biznesmenin grek, ish-president i

një klubi futbollit janë arrestuar edhe 3 shtetas shqiptarë të cilët konsiderohet se luajnë një rol të rëndësishëm në trafikimin e lëndëve narkotike në Ballkan. Biznesmeni u arrestua në Larisa dhe sipas mediave greke bëhet me dije se bëhet fjalë për Athanasios Karatzounis. Gjatë arrestimit, biznesmenit i janë sekuestruar edhe më shumë se 100.000 euro. Lënda narkotike e sekuestruar u gjet në dy vende të ndryshme, rreth 10 kg kokainë u gjet në një depo në Larisa ku dhe ai u arrestua, ndërsa kurse pjesa tjetër u gjet në një servis makinash në pronësi të një shqiptari. Policia arriti të gjurmonte biznesmenin duke hetuar anëtarët shqiptarë të grupit. Pritet të tjera hetime dhe arrestime të mëtejshme. Biznesmeni shkruajnë mediat edhe më parë ka qenë i akuzuar për kontrabandë cigaresh. Më 19 shtator 2000 ai u dënua me gjashtë vite burgim për kontrabandë cigaresh nga Holanda. Aktualisht të arrestuarit pritet të dalin para gjykatës



ndërsa sipas të dhënave të para biznesmeni shqiptar përshkruhet si një ndër më të rëndësishmit në tregun e hidrokarbureve dhe gazit me aktivitet në Shqipëri, Ballkan, Izrael, Turqi dhe Katar. "Report Tv" ka kontaktuar dhe me zyrën e Interpol Tirana dhe Prokurorinë e Krimeve të Rënda të cilat konfirmuan operacionin, por pa dhënë detaje se cili është biznesmeni shqiptar i arrestuar dhe roli i tij. Në

Shqipëri të dhënat për këtë operacion janë të rezervuara ndërsa mediat greke raportojnë se Karatzouni njihet në Greqi si person me pushtet në qarqet politike pasi ai është i afërm i një ish ministri dhe politikani të rëndësishëm në Greqi. Nëse droga do të dilte në treg do të kapte një fitim prej 2 milion euro, ndërsa sipas të dhënave kjo drogë ka mbërritur në Greqi nga Kolumbia në Ballkan e më pas në Greqi.

OFERTË PUNËSIMI

Kompania mediatike Shqiptarja.com kërkon të punësojë agjent marketingu që plotëson kriteret e mëposhtme:

PERSONAT E INTERESUAR TË DËRGOJNË CV E TYRE NË ADRESËN:

marketing@shqiptarja.com

TË KETË ARSIM TË LARTË
TË KETË PËRVOJË PUNE
TË JETË I GATSHËM PËR TË PUNUAR NË TERREN

Zbulohet salla e seksit online, kapet pronarja

Operacioni "Chat-Line 2" zbulon në Tiranë shtëpinë e kthyer në sallë teatrale seksi.

ELTON QYNO
TIRANE

Mashtrore vajza duke iu ofruar atyre para dhe sende me vlerë për ti shfrytëzuar si prostituta online, arrestohet tutorja dhe tre persona të tjerë mes tyre dhe një shtetas kosovar. Falë informacioneve të mara, policia e kryeqytetit zbuloi një sallë online të aktrimit të prostitucionit tek zona e "Komuna e Parisit", e cila kryente shërbime seksi on-line. Gjatë operacionit "Chat-Line 2" u arrestuan 6 femra, mes të cilave edhe tutorja. Po ashtu, në gjendje të lirë janë duke u hetuar edhe 3 vajza të tjera të reja, ndërsa klientët, të cilët kryesisht ishin të huaj, kryenin pagesa deri në 150 euro. Disa nga vajzat e bënin me dëshirë këtë punë, ndërsa disa mashtroheshin dhe kur donin të tërhiqeshin videot shërbenin si kërcënim e shantazh ndaj tyre. Vajzat detyroheshin nga tutorja që të ushtronin prostitucion online. Pak muaj më parë Policia ka arrestuar një tjetër



ABONIMI

Në këtë faqe, personat që kontaktonin fillimisht duhet të bënin një pagesë me kartë krediti që shkante deri në 150 euro në formën e një abonimi mujor.

grup, i cili gjithashtu përdorte chatin online për të ushtruar prostitucion.

OPERACIONI

34-vjeçarja me inicialet L.B ishte banuese në zonën e "Komunës së Parisit", në Tiranë dhe e kishte shndërruar apartamentin e saj në një shtëpi seksi. Për të gjetur vajzat, tutorja, herë pas here nxirrte njoftime në një gazetë si dhe në faqet on-line që ofrojnë vende pune, ku kërkonte vajza të moshës nga 18 deri 30 vjeçe. Në njoftime, puna që u kërkohet vajzave të kryhej nuk specifikohet, por

PRECEDENTI

Pak muaj më parë Policia ka arrestuar një tjetër grup, i cili gjithashtu përdorte chatin online për të ushtruar prostitucion.

ME TË HUAJ

Sipas burimeve të policisë, u bë me dije se klientët e këtyre femrave ishin kryesisht të huajt, por në disa raste komunikoheshin edhe me shtetas shqiptarë.

thuhej se ofrohej një pagesë e kënaqshme. Të interesuarat, pasi kontaktonin në telefon me 34-vjeçaren, bënin një intervistë pune dhe më pas instruktroheshin për të kryer sex on-line. Burime pranë policisë, bënë dije me dije se videot e para që kryenin këto vajza u përdorshin si kërcënim në rastet kur ndonjëra prej tyre dëshironte të largohej prej andej. Shërbimet e seksit ofroheshin përmes një faqeje në internet të quajtur "Star



Pamje nga ambienti

Privat". Në këtë faqe, personat që kontaktonin fillimisht duhet të bënin një pagesë me kartë krediti që shkante deri në 150 euro në formën e një abonimi mujor, ndërsa më pas kishte edhe pagesa të tjera gjatë bisedës që vajzat të moshës nga 18-30 vjeç u plotësonin atyre kërkesat me lodrat seksuale. Sipas të njëjtave burime, u bë me dije se klientët e këtyre femrave ishin kryesisht të huajt, por në disa raste komunikoheshin edhe me shtetas shqiptarë.

HETIMI

Nga veprimet hetimore të kryera nga Specialistët e Seksionit Kundër Trafiqeve të Paligjshme, në bashkëpunim me Prokurorinë e

Tiranë karezultuar se shtetasja L.B., prej një periudhe kohore të gjatë, me anë të mashtrimit punësonte vajzat e moshave të reja e më pas i shfrytëzonte ato për prostitucion. Gjatë kontrollit të policisë në shtëpinë publike, mbizotëronin lojërat e seksit, pranget, maskat dhe objekte të tjera që vajzat i përdornin për të joshur klientët e tyre. Në cilësinë e provës materiale u sekuestruan 7 njësi kompjuteri, 7 ekrane kompjuteri, si dhe 7 kamera për komunikime video on-line. Hetimet janë duke u kryer nga prokuroria e Tiranës, për veprat penale "Prostitucion", "Shfrytëzim për prostitucion", "Punësimi i paligjshëm" dhe "Fshehja e të ardhurave".

ISH-POLICI FATMIR HAMITI KRYEU VRASJE NË 1995 NË VLORË

Ekstradohet nga Italia ish-polici vlonjat, jetonte me identitet të remë

Ekstradohet nga Milano, shtetasi shqiptar Fatmir Hamiti i dënuar me 18 vjet burg për veprën penale "Vrasje me dashje", parashikuar nga Kodi Penal. Gjykata e Vlorës me vendimin penal nr. 77 datë 21.06.1996, shtetasin Fatmir Hamiti nga Dukati i Vlorës e ka dënuar me 18 vjet në burg për kry-

erjen e veprës penale "Vrasje me dashje". Si rezultat i bashkëpunimit të Interpol Tiranë me Interpol Roma, Itali, u bë i mundur arrestimi provizor i 54-vjeçarit në Milano, Itali, me qëllim ekstradimi drejt vendit tonë. Në qershor të vitit 1995, Fatmir Hamiti me detyrën polic, pas një grindjeje ka qëlluar 5 herë për vdekje me pistoletën

e punës, një bashkëkombas të tij në qytetin e Vlorës. Media italiane informojnë se shqiptari jetonte në Itali nën një identitet të rremë. Identifikimi e arrestimi i tij u bë i mundur falë bashkëpunimit mes Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë kriminale Interpol të Romës e Policisë së qytetit të Vlorës. Hamiti, në atë kohë

ishite punonjës në zyrën e emigrimit në Policinë e Vlorës dhe media italiane raporton se vrasja për të cilën u dënua ndodhi pranë gjykatës. Më pas, ai u bë protagonist i një arratisje spektakolare nga burgu, një vit pas kimit të kryer dhe që atëherë ka qenë në kërkim deri në kapjen e tij një vit më parë në Itali.



Fatmir Hamiti

AKSIDENTI

Fier, makina përplas biçikletën 54-vjeçari në Spitalin e Traumës

Një aksident ka ndodhur në aksin rrugor Fier-Roskovec ku për pasojë është plagosur një 54-vjeçar, i cili ndodhet në Spitalin e Traumës. Policia ka arrestuar Hajdar Braushi, 26 vjeç, banues në fshatin Cukalat, Berat pasi në aksin rrugor Fier-Roskovec, në fshatin Verbas, duke drejtuar mjetin tip "Fiat" me targa AA 923 MX, ka aksidentuar shtetasin me inicialet A.D, 54 vjeç, banues në fshatin Zharrëz, i cili udhëtonte me biçikletë. Shtetasi A.D ndodhet në spitalin e Traumës Tiranë nën kujdesin e mjekëve. Materialet i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier për veprën penale "Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor".


DOSJA NË GJYKATË

I vunë gjobë 10 mijë €, duke u prezantuar si Shullazi

Dy persona që prezantoheshin si miq të Emiljano Shullazit, në mënyrë që tu bënin presion një biznesmeni për ti marrë 10 mijë euro, janë dërguar në gjykatë si të pandehur. Prokuroria e Krimeve të Rënda thotë se i pandehuri Altin Vasili në kërcënimet dhe shantazhet

që i bënte me sms biznesmenit të xhamave Piro.B., prezantoheshin me mbiemrin e rrëme Altin Shullazi. Këtë skenar ai e kryente me qëllim për ti dhënë një sinjal biznesmenit të xhamave se ishte kushëri i Emiljano Shullazit dhe për pasojë Piro.B., duket të paguante shumën prej 10

mijë euro. Në rast të kundërt, biznesmeni dhe familja e tij do kishte probleme në vazhdim, probleme këto që do shkonin deri në ekzekutimin e anëtarëve të familjes. Mirëpo të gjitha veprimet kriminale të pandehurit Altin Vasili dhe bashkëpunorit të tij Durim Dervishi, të dy nga




Altin Vasili

fshati Bërçullë, janë përgjuar dhe survejuar nga policia dhe prokuroria.



Edhe 30 sekonda janë tepër për ata që na duan



NGA ALBA MALLEZI

vijon nga faqja 1

Na duket sikur duke fituar me domosdoshmëri armiqtë, fitojmë për momentin pushtetin absolut, duke harruar të mendojmë se sa dëm bëjmë në vend për të vradë, e me kalimin e kohës për të zhdukur, shpirtin fisnik.

Dihet. Në dashurinë e vërtetë, jo në atë të instikteve e të llogarive, njerëzit kërkojnë të ngjashmit. Dhe kur njeriu gjen të ngjashmin e vet, atëherë ekzistenca është një paqe pa krahasim e harmoni. Por pushteti, të mirat materiale e kanë mbuluar në vite këtë mision të vërtetë me kompromise të ndryshme. Për hir të arritjeve të disa objektivave bëhen strategji, por a janë më të mirat? Në Shqipërinë e viteve të fundit shoh të jetë kthyer në një kompleks inferioriteti i vërtetë vlerësimi i një miqësie, i një mendimi të njëjtë, i një historie lufte të përbashkët për të ndërtuar e përmirësuar gjëra edhe më të mëdha se jeta individuale.

Vërej se për të joshur armiqtë, miqtë shumëzohen me zero; jo vetëm që për ta nuk ka më një fjalë të mirë, por shpesh kompleksi që armiqtë të mos të të shohin me miqtë, i kapërcen rregullat e mirësjelljes njerëzore.

Të joshësh një armik mund të jetë një sfidë interesante, por ky operacion duhet kryer pa shkelur mbi miqësinë si një vlerë e grumbulluar në vite; ndryshe ndodh ajo që në Shqipëri shohim përditë e më shumë të ndodhë: shtimi pa masë i helmit dhe helmi dihet, herët a vonë do të japë efektin e tij.

Ta pranojmë se ka një energji të tepërt negative tek disa mes nesh. Mjafton të vëzhgojmë një kolektiv, një fis, një bashkëjetesë nëpër pallate, të bësh një kalim telekomande nëpër televizionet shqiptare në mbremje dhe e kupton se ligësia e hedhur në publik është bërë një interpretim i denjë për personazhet më dinakë të Shekspir. Nuk ka rëndësi se çfarë thonë dhe si argumentojnë, e rëndësishme për ta është të flasim keq. Përse, për ç'qëllim? Ç'është ky prodhim me tepri i të këqinjve ose më saktë i fjalëkëqinjve?

Më dinakët e kanë kuptuar mirë: Se të bëhesh mik me kë dëshiron të bëhesh, duhet të shtiresh si më i keqi armik. Vetëm në këtë mënyrë fiton vëmendjen e kujt dëshiron ta fitosh apo dhe të përfitosh prej saj/tij. "Të dua moj qëne", duket se tashmë është kthyer në një filozofi të Shqipërisë moderne. Të përfitosh vëmendje, dhe jo vetëm, nga ata që janë më të interesuar se çfarë mendojnë të tjerët, pavarësisht nivelit që mund të kenë, hileve që prodhojnë, ligësisë që shumëfishojnë, duket se është sporti më i preferuar.

Ky sport i shëmtuar e ka një ushqim: Dëshirën e pakuptimtë për të bërë me çdo kusht armiqtë miq, e miqtë e natyrshëm t'i flakësh tutje.

Kështu, edhe 30 sekonda vëmendje, po bëhen të tepërta, bezdisëse për miqtë. Motoja? Jemi shumë të përkushtuar për të dashuruar armiqtë dhe këta të fundit tepër të interesuar të shtojnë sa më shumë fjalët e helmta. Por një ditë, kjo strategji e gabuar, do të na helmojë pa kthim të gjithë.




Erion Veliaj me banorë të Farkës

Veliaj: Ulet çmimi i biletave të autobusit për ish-komunat

Kryebashkiaku deklaroi se ulja është arritur falë negociatave me kompanitë e transportit publik

do të vijojë bashkëpunimin edhe me donatorët për të përmirësuar infrastrukturën. "Ne kemi pasur disa rikonstrukcione me donacion, siç është "Shkolla e Mesme e Bashkuar". Jo vetëm që rregulluam shkollën, por me kërkesë të prefektit që në atë kohë ishte administrator, i vumë emrin e partizanit dëshmor 'Alush Bardhi'", tha Veliaj, ndërsa shtoi se investimet do të prekin edhe rrugët, kanalizimet, ndërtime e urave si dhe të qendrave komunitare.



Nga Farka, kryebashkiaku Veliaj dha një lajm të mirë edhe për banorët që jetojnë në ish-komuna, të cilët përfitojnë nga ulja e çmimit të biletave të autobusit. Ai deklaroi se falë negociatave me kompanitë e transportit publik, është arritur ulja më e madhe e çmimit të biletave për qytetarët. "Ka qenë një kërkesë e vazhdueshme për të gjithë zonën lindore të Tiranës, duke filluar nga Kërraba, Baldushku, Bërzhitë dhe stacionet që kalojnë në Farkë. Ne kemi pasur një takim dhe një negociatë që nuk ka qenë e lehtë, sepse siç e dini licencat e autobusëve janë dhënë nga ish-komunat, por megjithatë ne kemi bërë uljen më të madhe të tarifave që ka ndodhur ndonjëherë për linjat e autobusëve në fshat në Tiranën e madhe", u shpreh ai. Gjithashtu, Veliaj premtoi se brenda dy viteve të ardhshme do të marrë fund edhe problemi i saktësimi të hartave të tokës. "Unë e di që një nga problematikat kryesore ka qenë saktësimi i hartave të tokës dhe regjistrimi i akteve të marrjes së tokës në pronësi (AMTP). Fatmirësisht Prefekti, si ish-administrator njësie, e kupton fare mirë nevojën që kanë bashkia dhe prefektura për të bashkëpunuar për saktësimin e tokës dhe të kalojmë nga çudia me hartën e pronave, në një situatë ku secili merr aktin e marrjes së tokës në pronësi", tha ai. Kreu i Bashkisë deklaroi se Bashkia do të vijojë edhe projektin mbjelljen e pemëve të reja në kuadër edhe të projektit për Pyllin Orbital. Duke u ndalur tek investimet, Veliaj deklaroi se Bashkia

ADMINISTRATORËT

Biçakaj: Masa për ata që s'shlyejnë detyrimet e pallateve

Në Tiranë vijon ngritja e asambleve të banorëve të pallateve që do të zgjedhin administratorët e tyre. Report Tv bëri një vëzhgim në zona të ndryshme të kryeqytetit për të parë mbarëvajtjen e këtij procesi. Isidor Koti, administrator pallati në njesinë administrative nr 5, u shpreh se qytetarët kanë nisur të ndërjegjësohen për rolin e administratorit. Isidor Koti u shpreh se "Qytetarët kanë filluar të marrin indikacionet kryesore të zbatimit të ligjit. Banorët tashmë i dinë dhe besoj për një kohë të shkurtër do të ndërjegjësohen edhe për pagesat". Ndërsa Baltin



Baltin Biçakaj

Biçakaj, administrator pallati prej 13 vitesh, tha se ka ende persona që nuk shlyejnë detyrimet për shërbimet, por pas paralajmërimeve, do të merren ndaj tyre edhe masa administrative. Baltin Biçakaj tha se "Kemi rreth 3 muaj që kemi bërë mbledhjet e banorëve, kemi zgjedhur këshillat e pallateve dhe po pres të marr licensimin. Banorët janë të interesuar dhe po presin të përfundojë procesi. Me ligjin e ri personat që nuk paguajnë, pas 3 muajsh do t'i hedhim në gjyq, po besoj se me paralajmërimet që po bëjmë do të nisim të paguajnë. Po banorët sa i drejtohen administratorit për shqetësimet

që kanë? Banorë e njesisë 9: "Komunikojmë me administratorin. Psh digjet drita vijnë dhe e rregullojnë, është prishur pulla e ashensorin është thirrur mekaniku menjëherë. Me administratorin jemi të kënaqur". Ndërsa në zona të tjera të kryeqytetit banorët shprehen se ende nuk kanë një administrator pallati. 1147 administratorë kanë nisur punën për mirëmbajtjen e ambienteve të përbashkëta. 5000 pallate apo subjekte që ndajnë bashkëpronësinë në Tiranë, brenda 1 viti do të kenë administratorë të certifikuar nga Bashkia e Tiranës me qëllim disiplinimin e bashkëjetesës në komunitet.

Shkëlzen Maliqi: 90% Albin Kurti kryeministër i Kosovës

Analisti shprehet se LDK përcakton fituesin dhe se kjo forcë politike është më e prirur t'i bashkohet Albin Kurtit

ESENKA MELEQI
TIRANE

Përej mëse një jave Kosova ndodhet në një situatë të re politike pasi asnjë nga partitë apo koalicionet nuk arriti të fitonte shumicën e votave për të qeverisur e vetme. Koalicioni PAN i përbërë nga AAK, Nisma dhe PDK me kandidat për kryeministër Ramush Haradinaj arriti fitonte shumicën e votave si koalicion por jo mjaftueshëm. Surpriza sigurisht ishte lëvizja Vetëvendosja me në krye Albin Kurtin e cila doli forca e parë politike. Të dyja palët kanë ftuar partinë LDK që të formojnë qeverinë, por ende asgjë nuk është konkretizuar.

I kontaktuar nga "Shqiptarja.com" analisti i njohur Shkëlzen Maliqi, i njohur dhe si këshilltari i kryeministrit Edi Rama për rajonin, shprehet se LDK përcakton fituesin duke parashikuar se kjo forcë politike është më e prirur t'i bashkohet Albin Kurtit. "LDK-ja mbetet faktori kyç që përcakton fituesin, a do të


jete kryeministër Haradinaj apo Kurti. LDK me AKR-ën, edhe pse të goditura nga ngecja, tani e kanë komoditetin e zgjedhjes sepse edhe me Haradinajn edhe me Kurtin mbesin në pushtet. Por meqenëse koalicioni i mëparshëm me PDK-ne u ndëshkua në zgjedhjet, nuk duhet pritur se sërish do ta bëjnë gabimin e njëjtë. Janë më të prirur të ndihmojnë Kurtin" u shpreh Maliqi për Shqiptarja.com.

Dhe nëse vetëvendosja do të marrë në dorë qeverinë e Kosovës, a është gati kjo forcë politike për një hap të tillë?

Sipas Maliqit kjo do të jetë një sfidë e madhe për VV dhe mënyra sesi do të pajtohen ideologjikisht me LDK. "Do të jetë sfidë e madhe për VV- që si parti kanë administruar vetëm Prishtinën dhe ekziston përshtypja se nuk kanë mjaft kuadro me përvojë dhe profesionalisht të përgatitur për ta udhëhequr shtetin, aq më parë që deri dje edhe e kanë mohuar Republikën e Kosovës e tani duhet të punojnë për fuqizimin e këtij shteti të brishtë... do të jetë intere-



Albin Kurti



Shkëlzen Maliqi

REZULTATI

Koalicioni i Partisë Demokratike, Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës dhe Nismës për Kosovën, kryeson me 34.6 për qind, Lëvizja Vetëvendosje 26.7 për qind, Koalicioni i Lidhjes Demokratike, Aleancës Kosova e re dhe Alternativës me 25.8 për qind.

sant edhe si do të pajtohen ideologjikisht VV me LDK, ku e para vetëpërcaktohet si parti e majte, madje edhe ekstreme, kurse LDK është parti e djathtë. Disa parashikojnë se VV do të përjetoj katandisjen ideologjike si Siriza e Greqise kur të ballafaqohet me problemet reale ekonomike dhe social-

e" shprehet Maliqi.

A mundet që në Kosovë të përsëritet skenari i Maqedonisë apo të zhvillohen zgjedhje të reja?

Maliqi përjashton mundësinë e përsëritjes së skenarit të Maqedonisë duke thënë se brenda muajit Kosova do të ketë një qeveri të re duke përjashtuar edhe mundësinë që vendi do të shkojë në zgjedhje të reja. "Nuk ka shenja të bllokadës së situatës. 10 % janë gjasat se Haradinaj do të bëhet kryeministër, kurse 90 % janë gjasat se kryeministër do të bëhet Kurti" përfundon Maliqi. Kjo është një situatë e re politike në Kosovë e cila do të përballlet me plot sfida që të vijojë kursin europian.

Rezultatet e zgjedhjeve të

ALEANCAT

"LDK-ja mbetet faktori kyç që përcakton fituesin, a do të jete kryeministër Haradinaj apo Kurti. Por meqenëse koalicioni i mëparshëm me PDK-ne u ndëshkua në zgjedhjet, nuk duhet pritur se sërish do ta bëjnë gabimin e njëjtë. Janë më të prirur të ndihmojnë Kurtin"

parakohshme në Kosovë:

Në 11 qershor në Kosovë u zhvilluan zgjedhjet e parakohshme parlamentare, në një atmosferë të qetë pa ndonjë incident që do të minonte procesin zgjedhor. Koalicioni i Partisë Demokratike, Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës dhe Nismës për Kosovën, kryeson me 34.6

QEVERIA E KOSOVËS

Vdekja e liderit të ISIS Muhaxheri, Kosova: Luftë kundër terrorizmit

Qeveria e Kosovës ka reaguar pas vdekjes së liderit të ISIS-it për grupin e Ballkanit, Lavdrim Muhaxheri. "Qeveria e Republikës së Kosovës po i përcjellë nga afër zhvillimet pas njoftimeve për vrasjen e terroristit Lavdrim Muhaxheri. Qeveria rikonfirmon qëndrimin e saj të paluhatsëm për të luftuar inten-

sivisht dhe në mënyrë të vendosur çfarëdo ekstremizmi të dhunshëm dhe terrorizmin. U bëjmë thirrje qytetarëve të Republikës së Kosovës që të respektojnë dhe kultivojnë karakterin multikonfesional të Republikës së Kosovës. Nuk do të tolerojmë asnjë përpjekje apo tendencë nga qytetarët e saj për radikalizim dhe



Lavdrim Muhaxheri

bashkëngjitje në luftëra të huaja" mbyllet deklarata. Lavdrim Muhaxheri pak ditë më parë është vrarë në Siri, njoftimi u dha nga familja e tij në Kaçanik.

AMBASADORI I SHBA

Delawie: Qeveria e re të punojë për të mirën e qytetarëve

Ambasadori i SHBA-ve në Kosovë, Greg Delawie, lavdëroi mbajtjen e zgjedhjeve në vend, duke thënë se tashmë pret formimin e qeverisë së re të Kosovës, e cila do të punojë për të mirën e gjithë qytetarëve të saj. Ai këto komente i bëri me rastin e pritjes mirëseardhëse për të diplomuarit e programeve studimore master, të cilët i ka përgëzuar për arrijtjet e tyre. Duke folur rreth zgjedhjeve të parakohshme parlamentare të 11 qershorit në Kosovë, diplomati amerikan Delawie tha se ato ishin

demokratike dhe se u takon tashmë të zgjedhurve të rinj të popullit që të formojnë qeverinë e vendit. "Këtë javë vendi juaj po ashtu arriti diçka të rëndësishme me mbajtjen e zgjedhjeve demokratike të dielën dhe ju dhe bashkëqytetarët tuaj kanë folur dhe tashmë puna qëndron te përfaqësuesit e rinj të zgjedhur që të formojnë qeverinë që do të punojë në interesin më të mirë të qytetarëve të Kosovës. Zgjedhjet e ndershme dhe të pakontestuar janë thelbësore për demokracinë", tha ai.



Greg Delawie

VIDEO / ANALISTI
SHKËLZEN MALIQI:
90% KURTI
KRYEMINISTËR I
KOSOVËS



Për të parë videon në smartphonin tuaj skanoni QR CODE me APP të REPORT TV që shkarkohet falas

për qind, Lëvizja Vetëvendosje 26.7 për qind, Koalicioni i Lidhjes Demokratike, Aleancës Kosova e re dhe Alternativës me 25.8 për qind.

Me keto rezultate është e qartë se as fituesi nuk e ka mundësinë të formojë qeverinë pa një koalicion me subjektet e tjera politike, pasi surprizë ishte fitorja si forcë politike e VV.

Parlamenti i Kosovës përbëhet nga 120 vende dhe asnjë forcë politike nuk mundi të marrë shumicën. Nëse përqindjet e votave të fituara kthehen në karrige të Kuvendit, përbërja e re e legjislativit do të dukej afërsisht me 39 apo 40 deputetë të koalicionit të Partisë Demokratike të Kosovës, Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës dhe partisë Nisma. Pastaj, me 31 apo 32 deputetë të Lëvizjes Vetëvendosje, kurse koalicioni i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Aleancës Kosova e Re dhe Alternativës me 29 karrige.

Ndërkaq, komunitetet mbeten në kuotat e njëjta, serbët marrin 10 ulëse dhe pakicat tjera po ashtu 10 vende të garantuara. Në kushte të tilla, koalicioni PAN me kandidat për kryeministër Ramush Haradinaj dhe VV me kandidat për kryeministër Albin Kurti i kanë bërë ftesë LDK-së për formimin e qeverisë.

Ndahet nga jeta Helmut Kohl, ai që bashkoi Gjermaninë

Ishte kancelari më jetëgjatë pas Bismarckut, drejtoi vendin për plot 16 vite

Ish-kancelari gjerman Helmut Kohl ka ndër-ruar dje jetë në moshën 87-vjeçare. Ai udhëhoqi Gjermaninë për 16 vite, duke u bërë kancelari më jetëgjatë pas Bismarckut, ndërkohë që do të kujtohet përgjithnjë si arkitekti i ribashkimit të Gjermanisë, sikurse edhe për kontributin e jashtëzakonshëm politik dhe ekonomik në integrimin e Europës. Ai i dha emrin e tij një brezi të tërë, e njohur si “gjenerata Kohl”. Ai rezultoi tejet i përkrahur nga të rinjtë që u rritën gjatë epokës së tij.

Helmut Josef Michael Kohl u lind në Ludwigshafen më 3 prill të vitit 1930. Ai ishte vetëm 17 vjeç kur iu bashkua konservatorëve të Unionit Kristian-Demokrat (CDU), ndërsa ishte aktiv në këtë parti gjatë kohës që studioje për Histori, Ligj dhe Qeverisje, si dhe Politika Publike. Kohl u zgjodh kryeministër i Rheinland-Palatinat në vitin 1969. Në moshën 39-vjeçare, ai u bë personi më i ri që mbante këtë post. Në vitin 1976, CDU-ja dhe partia e saj simotër bavareze, Unioni Kristian-Social (CSU) e zgjodhën atë si kandidat në tyre për Kancelar në zgjedhjet parlamentare. Ai fitoi 48.6 për qind të votave, por ato sërish nuk ishin të mjaftueshme për të larguar nga pushteti socialdemokratët e Helmut Schmidt, në koalicion me liberalët e Partisë së Lirë Demokratike (FDP).

U deshën edhe 6 vite të tjera, deri më 1 tetor 1982, kur Kohl do të arrinte përfundimisht objektivin e tij. Udhëheqësi i opozitës u zgjodh Kancelar, duke rrëmbyer edhe numrin më të madh të deputetëve në Parlamentin gjerman. Ajo ishte njëkohësisht edhe një lloj vote mosbesimi ndaj socialdemokratëve të Kancelarit Schmidt, e Kohl erdhi në pushtet pas korjës së suksesit për ndarjen e Hans-Dietrich Genscher, udhëheqës i “FDP”-së, nga Schmidt. Kohl formoi aleancë

→ KARRIERA

Kohl u zgjodh kryeministër i landit të Rhin-Pfalci në vitin 1969. Në moshën 39-vjeçare, ai u bë personi më i ri që mbante këtë post. Më 1 tetor 1982 Kohl do të arrinte përfundimisht objektivin si kancelar

→ BASHKIMI

Kohl u tregua i shpejtë në marrjen e nismës për një plan prej 10 pikash, me synimin për të ribashkuar dy shtetet gjermane sa më shpejt që ishte e mundur më 1989. Arriti kulmin e karrierës në vitet 1989-1990

me “FDP”-në dhe u bë kreu i qeverisë. Në një lëvizje të debatueshme, vetëm pak muaj më vonë ai propozoi një tjetër votëbesim që sollën zgjedhje të reja, të cilat ai i fitoi bindshëm.

Gjatë viteve të para të qeverisjes së Kohl pati pakënaqësi. Ai fitoi reputacion jo vetëm për zgjidhjen e problemeve të brendshme, por edhe për pakësimin e tyre. Ai iu kundërpërgjig kritikave duke riformatuar vazhdimisht kabinetin. Vizita e tij në varrezat e qytetit gjerman, Bitburg, së bashku me presidentin amerikan Ronald Reagan në vitin 1985 nxiti debat, pasi aty ishin varrosur edhe pjesëtarë të “Waffen SS”, organizatës ushtarake naziste, së bashku me ushtarë amerikanë.

Në një tjetër rast, ai krahasoi kreun e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, Mikhail Gorbaçov, me

ministrin nazist të Propagandës, Josef Gëbels. Por ishin pikërisht politikën e Gorbaçovit, të njohura si “glasnost” dhe “perestroika”, që i sollën më shumë përfitimë Kohl.

Në qershor të vitit 1989, Kohl mirëpriti udhëheqësin sovjetik në Bonn. Në atë kohë, askush nuk e mendonte rënien e Murit të Berlinit, që do të ndodhte vetëm pak muaj më vonë. Kohl e përshëndeti Gorbaçovin me fjalët: Shumë njerëz i mbështesin shpresat e tyre në vizitën tuaj këtu. Njerëz nga vendi juaj dhe nga vendi ynë.


Situata pati një ecuri shumë më të shpejtë nga sa pritej dhe kur Muri i Berlinit ra, Kohl u kap në befasi. Ai ndodhej në udhëtim në Poloni, kur qytetarët e Gjermanisë Lindore mësynë kufirin e brendshëm gjerman dhe rojet e Gjermanisë Lindore

i lanë ata të lirë. Edhe pse Kohl u kthye menjëherë në vendlindje, ai nuk arriti të ishte i pari politikan i Gjermanisë Perëndimore për t’iu adresuar popullit gjerman në “Portën e Brandenburgut”. Ishin pikërisht fjalët e presidentit të Gjermanisë Perëndimore, Richard von Weizsacker, që u dëgjuan nga populli atë natë.

Kohl, gjithsesi, ishte i shpejtë në marrjen e nismës për të lançuar një plan prej 10 pikash, me synimin për të ribashkuar dy shtetet gjermane sa më shpejt që të ishte e mundur. Ai u përpoq të zmburpste frikën e vendeve të tjera mbi ribashkimin e Gjermanisë, pasi mund të bëhej shumë i fuqishëm dhe nacionalist.

“Ne, gjermanët, kemi mësuar nga historia jonë”, tha ai në atë kohë. “Ne jemi paqdashës, popull liridashës. Për ne, dashuria ndaj vendit tonë, ndaj lirisë, dhe shpirti për të qenë fqinj të mirë do të jenë gjithmonë bashkë”.

Kohl arriti kulmin e karrierës së tij politike në vitet 1989-1990. Ai u shpall si një yll i Gjermanisë Lindore. E pavarësisht futjes së taksës së solidaritetit për të ndihmuar në zhvillimin e ish-Gjermanisë Lindore, ribashkimi nuk mund të sillte “mrekullira” dhe Kohl nuk pati sukses në rritjen e standardit të jetesës në qytetet lindore. Shumë gjermano-lindorë që humbën vendet e tyre të punës, dësh-



Helmut Kohl

tuat të gjenin punonjës të rinj dhe u detyruan të transferoheshin në Perëndim.

Pakënaqësia me sistemin e Kohl u rrit më tej mes gjermanëve, shumica e të cilëve konsideronin se kancelari ishte i interesuar vetëm për ruajtjen e pushtetit. Në tetor të vitit 1998, një koalicion i SDP-së dhe “te gjelbërve” fitoi zgjedhjet parlamentare dhe, pas 16 vitesh, Helmut Kohl u kthye sërish të ishte anëtar i opozitës parlamentare.

Në korrik të vitit 2001, bashkëshortja e tij Hannelore do të vetëvritej me një mbidoze ilaçesh gjumi. Ajo vuante nga “photodermatitis”, një formë alergjie nga dielli. Kohl fitoi gjithsesi mirënjohjen e partisë së tij, kryesisht nën drejtimin e Kancelares aktuale dhe ish-të përkëdhelurës së tij, Angela Merkel, sikurse edhe mes

komunitetit ndërkombëtar.

Në moshën 78-vjeçare Kohl u martua me Maika Richter, dikur shoqe fëmijërie. Si një burrë shteti i madh, Kohl vijoi të shtonte mirënjohjet. Në maj të vitit 2011, ai u nderua me çmimin “Henry Kissinger”, për kontributin e jashtëzakonshëm në marrëdhëniet transatlantike. Ish-presidenti amerikan, Bill Clinton e quajti atë “burrin më të rëndësishëm evropian të shtetit, që prej Luftës së Dytë Botërore”. Vetëm pak përpara vdekjes, Kohl mori edhe një nderim të madh nga Republika Federale e Gjermanisë, që publikoi një pullë speciale në nder të tij. Në të shfaqet fytyra e Kohl në një sipërfaqe prej 12 cm katrorë, shoqëruar nga fjalët “Kancelari i ribashkimit, qytetar nderi i Europës”.

Afganistan

SHBA do të dërgojnë edhe 4 mijë trupa të tjera në vend

Departamenti amerikan i Mbrojtjes pritet të dërgojë 4 mijë trupa shtesë në Afganistan në fillim të javës së ardhshme. Lajmin e ka bërë të ditur një burim zyrtar për “Associated Press”, pak pasi presidenti Donald Trump i dha sekretarit James Mattis autoritetin për të përcaktuar numrin e trupave për të çuar në vendin e përcarë nga lufta. Dërgimi i njëjësive të reja e çon numrin e trupave amerikane në Afganistan në mbi 14 mijë. Gjithashtu, ky vendim përbën vendosjen më të madhe ushtarake amerikane të presidentit Trump, që kur ai mori detyrën në janar. Lajmi vjen në një moment jetik për Pentagonin dhe planet e tij për t’i dhënë fund luftës 16-vjeçare. Më 14 qershor, pak orë para se Trump të njoftonte dorëzimin e autoritetit tek Mattis, ky i fundit kishte prezantuar një përllogaritje në komisionin e forcave të armatosura në Senat. “Aktualisht nuk jemi duke fituar në Afganistan dhe do të punojmë që ta ndryshojmë këtë situatë sa më shpejt të jetë e mundur”, kishte thënë Mattis.



PROCESI/ AKUZA KRYEPROKURORIT PËR “GJUETI SHTRIGASH”

Trump pranon se po hetohet për pengimin e drejtësisë

Presidenti amerikan Donald Trump pranoi se po hetohet për shkarkimin e ish-drejtorit të FBI-së, James Comey, në kuadër të hetimit më të gjerë për ndërhyrjen ruse në zgjedhje. Si zakonisht, përmes një mesazhi në “Twitter”, Trump njoftoi për këtë zhvillim të ri, ndërsa akuzoi zëvendësprokurorin e Përgjithshëm për “gjueti shtrigash”. “Po hetohem për shkarkimin e drejtorit të FBI-së, nga njeriu që më tha të shkarkoj drejtorin e FBI-së”,

shkruan Trump.

Ky njeri është pikërisht zv.prokurori i Përgjithshëm, Rod Rosenstein, i cili shkroi një memorandum ku kritikonte Comey, gjë që u përdor si justifikim nga Shtëpia e Bardhë. Megjithatë, pas shkarkimit të Comey, Trump tha se kishte vendosur ta bënte këtë me apo pa memorandumin e numrit dy të Departamentit të Drejtësisë, prandaj sulmi aktual ndaj Rosenstein duket si justifikimi i radhës i presidentit amerikan. Nuk është e qartë

nëse Shtëpia e Bardhë u lajmërua zyrtarisht për hetimin ndaj Trump, apo nëse presidenti u bazua te raportet e medieve për këtë. Rosenstein mori përsipër hetimin për Rusinë pas shkarkimit të Comey dhe më pas ia kaloi atë prokurorit special, Robert Mueller, i thirrur enkas për këtë hetim. Mediet raportuan se, veç hetimit për Rusinë dhe punësimit të prokurorëve veteranë për këtë qëllim, Mueller nisi edhe një hetim për Trumpin për pengim të drejtësisë pas shkarkimit



Donald Trump

të James Comey, sidomos pasi ish-drejtori i FBI-së tha se presidenti i kërkoi të hiqte dorë nga hetimi i ish-këshilltarit të Sigurisë Kombëtare, Michael Flynn.



Nijazi Lleshi, dekorohet nga ish-presidenti Bamir Topi

Gemal Shalsi	10155	24/04/2017	Titulli "Mjeshtër i madh"
Nijazi Lleshi	10154	24/04/2017	Titulli "Mjeshtër i madh"
Naim Plikut (pas vdekjes)	10153	24/04/2017	Titulli "Mjeshtër i madh"
Pareshqevi Sahatçi	10139	14/04/2017	Titulli "Mjeshtër i madh"

Faksimile ku tregohet se është dekoruar Nijazi Lleshi në datën 24.04.2017

Gafa e presidentit Nishanit, 2 herë ‘Mjeshtri i madh’ Nijazi Lleshit

Presidenti ka dekoruar plot 32 artistë, aktorë, kompozitorë e këngëtarë

Dekorata “Mjeshtër i madh” dhe “Nderi i Kombit” për të gjithë. Në këtë mënyrë e ka menduar presidenti Nishani që t’i jap lamtumirën postit të Presidentit të Republikës së Shqipërisë. Vetëm gjatë muajit qershor janë dekoruar plot 32 artistë, aktorë, kompozitorë e këngëtarë, si dhe figura të showbizit. Zelli i tepruar i presidentit për të ndarë dekorata e ka shtyrë të bjerë pre e gafave që tregojnë mungesën e përgjegjësisë për njohjen e karrierës së personaliteteve që marrin titujt presidencialë.

Presidenti i Republikës, Bujar Nishani i ka akorduar në datë 24/04/2017, me numër dekreti 10154 sportistin Nijazi Lleshi me titullin “Mjeshtër i madh” me motivacionin: “Në vlerësim të kontributit të dhënë ndër vite për lartësimin dhe rritjen cilësore të sportit të basketbollit, përmes një pune të palodhur dhe arritjes së rezultateve të niveleve të larta kombëtare dhe ndërkom-bëtare, duke entuziazmuar sportdashësit shqiptarë”.

Mirëpo po të njëjtin titull Nijazi Lleshit ia ka akorduar edhe ish presidenti i Republikës, Bamir Topi më 6 shkurt të vitit 2012, ku ka dekoruar me “Mjeshtër i Madh” 6 emra të shquar të basketbollit shqiptar ndër vite, Besnik Pëllumbin (pas vdekjes), Bujar Shehun, Vasil Shakën, Viktor Papavangjelin, Nijazi Lleshin dhe Petrit Stefën.

Nijazi Lleshi tashmë ka dy dekorata në shtëpi “Mjeshtër i Madh”, me dekret nr. 7260 nga Bamir Topi dhe këtë tjetrin me dekret nr. 10154 nga Bujar Nishani.



Nijazi Lleshi

SSSSSSSSSS

“Mjeshtre e madhe”, dekorohet edhe Matilda Makoçin



Matilda Makoçi

Presidenti i Republikës Bujar Nishani ka nderuar me Dekoratatën “Mjeshtër i madh” aktoren e mirënjohur Matilda Makoçi. Vetëm gjatë muajit qershor janë dekoruar plot 32 artistë, aktorë, kompozitorë e këngëtarë, si dhe figura të showbizit. Janë dekoruar me mjeshtër i madh këngëtarja Aurela Gaçe, aktori Xhevdet Ferri, aktori Viktor Zhysti, kompozitori Kujtim Laro pas vdekjes, regjisori Kujtim Çashku, aktorët Guliem Radoja, Anisa Markajani, Eva Alikaj e Matilda Makoçi. Janë de-

koruar me mjeshtër i madh edhe këngëtarët Eli Fara e Rozana Radi, si dhe aktori Julian Deda e më gjerë. Aktorja Matilda Makoçi është dekoruar me nr. dekreti 10432 me Titullin “Mjeshtër i madh” me motivacionin: “Si mjeshtre e rrallë dhe interpretuese e paharrueshme e personazheve të shumë realiste të artit skenik dhe atij kinematografik të vendit tonë, duke portretizuar karaktere të shumta dramatike, tragjike e romantike, të dashura e të vlerësuara nga artdashësit shqiptarë”.

Në fokusin e lexuesit online

[SHQIPTARJA.com]

LAJMET MË TË LEXUARA DJE

- Trump medalje ekselence nxënësit shqiptar, i biri i ish-ministrit të Brendshëm
- Kryebashkiaku i Shkupit në mitingun e LSI/
- Lul Berisha sms Ben Blushit: Më njeh, ja kur jemi takuar
- Rrëfëhet De Biasi: Nata që vendosa largimin
- Seks me biznesmenë kosovarë në motelet e Tiranës për 200 €
- Tahiri: LSI është një kalë që po ngordh, do dalë në opozitë
- Listat e partive, emrat e fshehtë të kandidatëve për deputetë
- Ruçi: S’dekreton qeverinë? Meta i pari President që shkarkohet
- Seks online në chat, kapen 6 vajza e tutorja në Tiranë
- Ekstradohet nga Italia ish-policia vlonjat, vrau në vitin 1995

LAJMET MË TË KOMENTUARA

- Meta: Rama, lideri i Ebolës, Basha lider pa karakter, serioz veç Berisha
- Tahiri: LSI është një kalë që po ngordh, do dalë në opozitë
- Rama: Nëse Ruçi do kryeministër me zgjedhje të vjedhura, ne s’e lejojmë
- Fotolajm /Bulevardi i Ri, Tiranës i shtohet një tjetër korsi biçikletash
- Kryebashkiaku i Shkupit në mitingun e LSI/
- Shkarkimi i Metës? Flet Hazizaj: E pamundur, deklarata elektorale

VIDEOT MË TË KLIKUARA

Ruçi: S’dekreton qeverinë? Meta i pari President që shkarkohet

Seks me biznesmenë kosovarë në motelet e Tiranës për 200 €


Boss-i shqiptar i gazit kapet me 20 kg kokainë në Greqi

Për të parë videon në smartphonin tuaj skanoni QR CODE me APP të REPORT TV që shkarkohet falas

SONDAZHI IDITES

A mendoni se vërtet De Biasi e mbylli ciklin në Kombëtaren Shqiptare?

Rezultati i Sondazhit



SHËNIM:

Sondazhet online të Shqiptarja.com, nuk kanë vlerë statistikore. Behet fjalë për pyetje që u bëhen të gjithëve dhe jo kampionëve të përpunuar në mënyrë shkencore. Pra, kanë si qëllim të vetëm të lejojnë lexuesit të shprehin mendimin e tyre rreth temave të aktualitetit. Megjithatë, çdo lexues, mund të votojë vetëm një herë në ditë



2.315 | 331 985
KOMENTET E DJESHME | TOTALI LIKE

Shqipëria e Shqiptarvet
Vdekje Trathtarvet

THIRRJE

Janar 1944

Partia Komuniste e ka çfaqur haptazi programin e saj satanik, i cili është thjeshtësisht „t'a hedhë Atdheun t'onë të dashur në gjak, lot, tym e flakë, Ajo është bërë një vegël e verbër e sërbeve Dushan e Meladin, të cilët, nën maskën e Komunistit kërkoi me çdo mënyrë t'a transformojnë Shqipërinë në një gjermadhë dhe vorrezë të përgjithëshme, për të realizuar kështu ëndrën e tyre imperjaliste!

Partia komuniste kërkoi të marrë në dorë pushtetin e Shtetit, duke përdorur për këtë qëllim çdo mjet të poshtër, si dhe terrorin më të tmerrshëm që njih historia. Ajo djeg shtëpira, plackit çdo gjë që gjen dhe vret njerëz të pa fajshëm, vetëm e vetëm se nuk kanë dëgjuar të reshohen në radhët e saj!

Ajo dikur predikoi „Demokrasinë popullore“ si regjimin më ideal për Shqipërinë. Kjo gjë gaboi disa njerëz të cilët ranë në grackën e madhe të vetë-qojtur Këshillit Nacional-Çlirimtarë, që është një këmbë tërësisht shqiptare dhe punon e lufton vetëm për të mirën e Shqipërisë dhe të popullit saj. Këtë gjë e vërteton programi i saj i qartë, i çfaqur botërisht me anën e „Dekalogut“ „Atdheu mbi të gjitha e mbi të gjithë dhe Shqipëria vetëm e Shqiptarvet“ janë parimet themelore të „Ballit Kombëtar“.

Partia Komuniste kënaqet nga gjaku dhe mjerimi... Përkundrazi Organizata jonë ndjen dhimbje për çdo frikëqësor dhe bën ç'është e mundur që të kursejë edhe pikën e fundit të shqiptarit. Dhe ky adryshim është i natyrshëm, sepse e para është terroriste, anarshiste dhe anti-

kombëtare; vepron për të huajt. Përkundrazi e dyta është kombëtare dhe punon vetëm për të mirën e vëndit e të popullit. E para kërkoh t'a hedhë vëndin në greminë e anarsh; e dyta kërkoi t'i sigurorë qetësinë paqen dhe lumtërinë.

Xhelati Mehmet Shehu, me shokët e tij zënë robër ballistë dhe i vrasin! Vrasja e 62 luftëtarëve robër nacionalistë të ngjethmishit. Përkundrazi çetat e „Ballit Kombëtar“, zënë robër komunistë dhe i lëshojnë sepse janë shqiptarë, të gabuar ose të rekrutuar me zor prej krejtëve anarshistë-terroristë. Neve na dhëmben shqiptarët, përkundrazi Mehmet Shehut me shokë u kënaqet shpirti kur lyejn duart me gjakun e tyre të pajajshëm! Kush ka kënduar traktet e Xhelat Staraveckës siqurisht ka ndërjet tronditje të thellë shpirti nga terrorizmat që përdorin Dushani e Meladin dhe këlyshit e tyre...

Partia Komuniste është shkakëtare e vëllavrasjes. Ajo e klluvuri në zbatim me tërë egërsinë. Dhe për të vënë në veprim planin e saj satanik, ajo u bashkua me të huajt dhe sidomos me ushtarët italianë, që i kanë akoma duart të lyera me gjakun e shqiptarit, dhe po djeg e vret pa-mëshirë. Qëllimet e Partisë Komuniste terroriste, anarqiste dhe pseudo-nacional çlirimtare, vihen në dukje nga vetë qarkorja e saj, që u drejtonte degave të yeta, qarkore e cila ra në duart e Organizatës s'onë dhe u botua. Në këtë qarkorë, që ka një përmbajtje nga krejt gjer në fund anti-kombëtare, jepeu udhëzime për të luftuar „Ballin, dhe „Nacionalizmën shqiptare“.

„Nacionalizmi anarqistë duan të vendosin me çdo kusht një regjim diktatorial në këtë vënd. Mjer Shqipëria dhe populli në qoftë se Mehmet Shehu, Xhelati më i math që ka nxjerë raca shqiptare, bashkë me shokët e tij Gjin Marku, Bedri Spahiu, Shemshi Totozani, Tahir Kadareja, Qemal Karagoji, Hysni Kapua, Nexhip Vinçani, Jorgo Plaku, Teki Kolaneci, Josif Pashko, Petrit Dume, Agnsh Gjergjevica, etj. i a mbrijnë qëllimit. Ata qysh tash, pa marrë fuqinë në dorë, kanë bërë tmerrin dhe

po djegin e vrasin pa mëshiri! Po nesër, në qoftë se—Zoti mos e dhëntë—vinë të fuqi ç'do të bëjnë? — Shkretinë e kasaphanë!

Përkundrazi organizata e jonë ka premtuar dhe do përpiqet që në Shqipëri të vendoset një demokraci me baza shoqërore moderne, ku çdo nënshlehtësi të gjejë lirinë e fajtës e të mendimit, mirëqënie dhe lumtërinë. Natyrisht vendosja e këtij regjimi do të lihet në vullnetin e plotë të popullit pa qënë i imponuar Populli është sovran dhe zëri i tij është zëri i Perëndisë. Organizata jonë do t'i përunjat dëshirës dhe vullnetit të popullit, jo me fjalë po me punë.

Neve nuk dëham t'i imponojmë askujt vullnetin t'onë. Neve respektojmë çdo ideologji dhe tendencë politike. Vetëm sot-për-sot kërkojmë që çdo shqiptar të jetë i bashkuar nën hijen e Flamurit Kombëtar dhe të gjithë tok të veprojnë për shpëtimin e Shqipërisë. Neve nuk duam qalashëve anarqistë që e përdorin fjalën „Liri e Popullit, vetëm për tallje e mashtrim. Ata e përdorin emrin e shenjtë të popullit vetëm sa për sy e faqe, sepse në të vërtetë as e kanë në mendë dhe as e përfillin fare. Përkundrazi e djegin dhe e vrasin.

Neve respektojmë edhe partinë Komuniste, e cila nesër—në një regjim demokratik—të ketë të gjitha të drejtat të veprojnë si një parti politike, ashtu si do të ketë një të drejtë të tillë edhe Partia Komuniste italiane në Itali, e cila është bashkuar me të gjitha partitë e tjera dhe vepron bashkërisht për çlirimin e Italisë.

Që neve respektojmë Partinë Komuniste, provohet nga fakti që në gjirin e organizatës s'onë ka edhe komunistë, të cilët, duke ruajtur ndjenjat e veta, bashkëpunojnë sot për një qëllim të përbashkët: për lirinë e Shqipërisë. Neve jemi vetëm kundër pseudo komunistëve anarqistë dhe terroristë, të cilët janë bërë tmerri i popullit dhe kundër të cilëve janë edhe vetë komunistët e vërtetë.

Komunistë ka edhe gjatë në Itali, Francë, Hollandë, Belgjikë etj. po këta nuk djegin dhe

nuk vrasin vëllezërit e tyre, siç bëjnë kuqalashët tanë. Ata janë të bashkuar me të gjitha partitë dhe veprojnë së toku për lirinë dhe të mirën e vëndosë të tyre. Veprojnë kështu sepse më parë se çdo gjë tjetër janë italianë, francezë, holandezë ose belgjanë. Kuqalashët t'anë veprojnë ndryshe sepse janë pseudo-komunistë, janë anarshistë, janë terroristë, atdhe-mohonjës, janë vegla të verbëra të vënd në dispozicion të huajve. Po me gjithë këtë, Organizata jonë u ndërri dorën e bashkëpunimit edhe këtyre dhe kërkoi që dhe ata të hynin në rugë të drejtë e të dobishme për Shqipërinë. Mbledhja e Mukajt vuri bazat e një bashkëpunimi, i cili u prit me gëzim nga gjithë populli shqiptar. Mirëpo kur nuk ishte tharë edhe nënshkrimi i delegatëve, partia komuniste ose këshilla nacional-çlirimtare e refuzoi pranimin e këtij bashkimi. Natyrisht kjo ndodhi sepse ky bashkim—që ishte për të

pranua nga sërbebt Dushanë e dhe Meladin, kryetarë efektivë të kuqalashëve terroristë, që veprojnë për çkatërimin e Shqipërisë!

Nuk është e para herë që pseudo-komunistët na kanë qënjyer. Ata as kanë dashur dhe as e duan bashkimin. Zaten nuk munt t'a duan kurrë një gjë të tillë, gjer sa lanë në shërbim të sërbeve dhe gjer sa kërkoi që pushtetin e Shtetit t'a kenë në duar të tyre. Për anarqistët komunistë kush nuk është me t'a, është armik dhe vritet pa mëshirë. Për xhelatët e sipërmë ka më tepër vëllezë një anarqistë këzë, se sa një shqiptar i mirë, i urtë dhe i ndershëm, po që s'është me t'al

Organizata Ballit Kombëtar bazohet mbi patriotizëm dhe humanitarizëm, kurse kuqalashët anarqistë bazohen mbi anti-kombëtarizëm dhe kriminalitet. Nuk flasim ne, po flasim ata që janë çkëputur nga reshatat e tyre. Shqiptarë!

Ju e shihni vetë me sytë t'uaja për ditë çkatërimet dhe masakrat që bëjnë kuqalashët anarqistë, të cilët e hodhën vëndin në vëlla-vrasje, tym e flakë. Ju e shihni vëhtë se ku

kërkoi t'a çojnë vëndin pseudo-komunistët e Shqipërisë, të udhëhequr nga sërbebt Dushan e Meladin. Ju e shihni vëhtë se në ç'greminë po hyn Atdheu ynë i dashur prej xhelatit Mehmet Shehut me shokë.

Në qoftë se në krakarorët t'uaaja, ka vënd ndjenja atdhetare dhe ajo njerëzore, atdhetare duhet të dridhen zemrat t'uaaja nga tmerri i math i kuqalashëve anarqistë. Po njëkohësisht duhet të vihen edhe në lëvizje për të shpëtuar popullin nga kjo gjëndje kaotike.

Indiferenca është në këto çaste trathëtit. Neve kërkoi nga gjithë shqiptarët që të vënë në dispozicion të Atdheut gjithë shpërkjejen dhe energjinë e tyre. Eshhtë gabim në qoftë se kujton nonjë që t'a kalojë këtë furtunë në me qetësi dhe rahatllëk. «Kush qesh sot, duhet t'a dijë se do të qajë nesër».

Nacionalizmi shqiptar, që i ka dalë zot Atdheut në çaste kritike, na dëshim do anarshia dhe çdo kërcënim tjetër, të kuqalashëve terroristë dhe të pseudo-nacional-çlirimtarëve.

Organizata jonë thret të kethehen në rugën e drejtë të gjitha ata që për gabim ose për frikë janë reshtuar në radhët e partis pseudo-Komuniste. Kush është Shqiptar dhe kush nuk mōhon sishn e mëmës, kush ka dhimbje e dashuri për këtë Shqipëri e për këtë popull, bën një tradhëti po të qëndrojë akoma në radhët e pseudo-komunistëve ose pseudo-çlirimtarëve, duke bërë sehir tmerrin e vëllavrv-sjen dhe katastrofin!

Prandaj largojuni sa më parë nga reshatat e milicisë së Dushanit e Meladinit dhe forcon reshatat e Organizatës Nacionaliste, që përplqen vetëm për të mirën e Kombit e të popullit shqiptar.

Kjo është thirrja që ju bën Atdheu, populli dhe hiri i martirëve të Kombit që dhonë gjakun për liri!

Kjo është thirrja që ju bën Organizata Nacionaliste «Ballit Kombëtar» Kallnor 1944

Balli Kombëtar

Shqipëria e Shqiptarvet
Vdekje Trathtarvet

Partia Komuniste e ka çfaqur haptazi programin e saj satanik, i cili është thjeshtësisht „t'a hedhë Atdheun t'onë të dashur në gjak, lot, tym e flakë!“ Ajo është bërë një vegël e verbër e sërbeve Dushan e Meladin, të cilët, nën maskën e Komunistit kërkoi me çdo mënyrë t'a transformojnë Shqipërinë në një gjermadhë dhe vorrezë të përgjithëshme, për të realizuar kështu ëndrën e tyre imperjaliste!

Partia Komuniste kërkoi të marrë në dorë pushtetin e Shtetit, duke përdorur për këtë qëllim çdo mjet të poshtër, si dhe terrorin më të tmerrshëm që njih historia. Ajo djeg shtëpira, plackit çdo gjë që gjen dhe vret njerëz të pa fajshëm, vetëm e vetëm se nuk kanë dëgjuar të reshohen në radhët e saj!

Ajo dikur predikoi „demokrasinë popullore“ si regjimin më ideal për Shqipërinë. Kjo gjë gaboi një sasi nacionalistësh, të cilët ranë në grackën e madhe të vetë-qojtura Këshillit Nacional-Çlirimtarë, që është një gjenjeshitër dhe mashtrim. Partia Komuniste ndjek rregullin e saj dhe zbaton sistematikisht programin e vetë tematikisht progamin e vetë çlirimtarit nga nacionalizmi kryetarë efektivë të kuqalashëve terroristë, që lozin në këtë rast rolin e „jallan shahitit!“ Me gjithë këtë, përgjegjësia rëndon e njëlojtë për të gjithë. Bile, për këta të fundit, bëhet akoma më e rëndë, gjer sa kanë guximin të quhen nacionalistë dhe nga ana tjetër, dashur pa dashur, ndihmojnë terrorin!

Organizata jonë është thjeshtësisht shqiptare dhe punon e lufton vetëm për të mirën e Shqipërisë dhe të popullit të saj. Këtë gjë e vërteton programi i saj i qartë, i çfaqur botërisht me anën e „Dekalogut“. „Atdheu mbi të gjitha e mbi të gjithë dhe Shqipëria vetëm e shqiptarëve“ janë parimet themelore të „Ballit Kombëtar“.

Partia Komuniste kënaqet nga gjaku dhe mjerimi. Përkundrazi Organizata jonë ndjen dhimbje për çdo frikëqësor dhe bën ç'është e mundur që të kursejë edhe pikën e fundit të shqiptarit. Dhe ky adryshim është i natyrshëm, sepse e para është terroriste, anarshiste dhe anti-

TRAKTI I BALLIT

PROGRAMI SATANIK I PARTISE KOMUNISTE: GJAK, LOT, TYM E FLAKE

Thirrja e janarit 1944/ „Ajo është bërë një vegël e verbër e sërbeve Dushan e Meladin, të cilët, nën maskën e Komunistit kërkoi me çdo mënyrë t'a transformojnë Shqipërinë në një gjermadhë dhe vorrezë të përgjithëshme, për të realizuar kështu ëndrën e tyre imperjaliste...“

SHQIPNIJA E SHQIPTARVET
VDEKJE TRATHTARVET

THIRRJE
Partia Komuniste e ka çfaqur

haptazi programin e saj satanik, i cili është thjeshtësisht „t'a hedhë Atdheun t'onë të dashur në gjak, lot, tym e flakë!“ Ajo është bërë një vegël e verbër e sërbeve Dushan e

Meladin të cilët, nën maskën e komunistit, kërkoi me çdo mënyrë t'a transformojnë Shqipërinë në një gjermadhë dhe vorrezë të përgjithëshme, për të realizuar kështu

ëndrën e tyre imperjaliste!
Partia Komuniste kërkoi të marrë në dorë pushtetin e Shtetit, duke përdorur për këtë qëllim çdo mjet të poshtër, si edhe terrorin më

Rrëfëhet ish-trajneri De Biasi: Nata që vendosa largimin

Ish-trajneri ka treguar në mediat italiane etapat që sollën këtë fund të aventurës së tij me kuqezinjtë

Pas zyrtarizimit të "divorcit" me Kombëtaren shqiptare, Gianni De Biasi ka treguar edhe në mediat e vendlindjes së tij etapat që sollën këtë fund të aventurës së tij me kuqezinjtë. Në emisionin "Tutti Convocati" në "Radio 24", ish-tekniku i kuqezinjtë ka treguar për sakrificat që i është dashur të bëjë në Kombëtare, si e përjetoi eksperiencën mes shqiptarëve për të cilët nuk ka munguar një paralelizëm edhe me kinezët.

Saqëndrovetje? Të kemi parë duke qarë...

Le të themi se është pak të thuash që dje isha shumë i emocionuar. Janë 5 vite e gjysmë jetë, bashkë me shumë persona të tjerë dhe është diçka e bukur të kesh bërë diçka në një vend, ku askush nuk mund ta hipotetizonte se do ta arrinin atë që kisha menduar që të miqësorja e parë me Gjeorgjinë. Ajo ishte eksperiencia e parë dhe mendoj se nga aty filluam udhëtimin e gjatë.

Një trajner e ndien kur është koha për t'u larguar, nuk është çështje kontratash.

Po, po. Është çështje ndjesish, se ti mund t'i thuash të njëjtat gjëra të njëjtit grup që ia ke thënë edhe vitin më parë dhe nuk kanë të njëjtën tërheqje.

Duke mos pasur mundësinë të ndryshosh shumë lojtarë, duke menduar që të konfirmosh pjesën më të madhe të grupit, nuk mendoj se mund të kisha tërheqjen e viteve të mëparshme.

A u pendove që nuk u largove pas Europianit?

E kemi përjetuar mirë atë, edhe si protagonistë. Edhe në "Veldrom" ne humbëm me Francën, pasi kishim qenë afër golit duke goditur shtyllën dhe ata nuk bënë asgjë deri në minutën e 89. Pas Europianit shprejsoja që edhe ne të kishim mundësinë të merrnim një shtysë dhe të fitonim forcë të re nga ana cilësore. Por, në fakt, nuk e pashë këtë ndryshim ritmi që prisja dhe kjo është paksa gjëra që më la një shije të keqe, pasi këto djem u kënaqën me atë objektivi, sado i rëndësishëm të ishte, por ishte vetëm një objektivi.

A e ke ndjesinë që pas Europianit dikush e humbi kontaktin me realitetin për pritshmërinë me një grup, ku janë Spanja me Italinë?

Në mënyrë të pandërgjegjshme askush nuk do ta pranojë, por është fjalimi i parë që i kam bërë ekipit, që ne i mendojmë të njëjtat gjëra por nuk i bëjmë më. Me atë zjarr, vendosmërinë që kishim kur arritëm

një objektivi që ishte diçka e pamendueshme në vigjilje. Sot mendojmë se jemi lojtarë të afirmuar. Mendoj se ata ndihen të ngopur nga një këndvështrim, edhe pse në ndeshjen e fundit me Izraelin më treguan gjëra të ndryshme, por nuk mund të ndryshoj ndjesitë e momentit. Ajo që më ka shqetësuar ishte fakti që në miqësoren e 10 ditëve më parë, në miqësoren kundër Luksemburgut, po fitonim 1-0 dhe duhej ta stërfitonim, por e humbëm 2-1. Mendoj se një skuadër si Shqipëria nuk mund të mos e këtë si rregull kryesor të jetë e përqendruar që nga minuta e parë deri te e fundit.

A e vendosët atë natë?

Po, atë natë e vendosa që do të largohesha nga skuadra.

Sa larg është futbollit i vendeve si Shqipëria nga ai i vendeve të mëdha, pasi surprizat e Europianit të kaluar janë thujse të gjitha jashtë Botërorit?

Jeton gjithmonë me diskutimin e emocioneve, motivimit. Gjendesh në një realitet që nuk kishe arritur ndonjëherë dhe jep jo 100%, por 150%. Janë realitete të ndryshme si Islanda që ka një projekt teknik të vlefshëm, edhe pse me një popullsi



Gianni De Biasi

të vogël. Ata kanë lojtarë që arrijnë të shprehen mirë në kampionate të ndryshme. Problemin kryesor ne e kemi te futbollit i bazës, te futbollit në Shqipëri. Kemi 3 milionë banorë, por kemi edhe 5-6 milionë të shpërndarë nëpër botë, them tani se jemi më shumë se kinezët, pasi gjej shqiptarë në çdo cep të botës. Është mundësia të punosh, por duhet planifikuar puna e bazës që nevojitet.

A do të jetë e ardhmja në Serinë A, mos duhej bërë kjo lëvizje dy muaj më parë?

Absolutisht jo, nuk kam ambicie për ndonjë kthim në Itali. Nëse do të ishte e mundur do të dëshiroja të qëndroja jashtë, në ndonjë realitet tjetër, federatë apo klub, ku të më jepet mundësia, një projekt ku unë jam në qendër dhe jo që pas dy humbjeve të më kthejnë në shtëpi. Absolutisht

nuk mendoj të marr pjesë një realitet të tillë.

Kështu ishte në 5 vite e gjysmë te Shqipëria...

Të kesh letër të bardhë dhe mundësinë për të marrë lojtarët që ti i ndien më të përshtatshëm për mënyrën se si e interpreton futbollin, jo vetëm në aspektin teknik por edhe nga pikëpamja e bujarisë ndaj shokut të skuadrës, të krijosh një skuadër të vërtetë ku secili ka një funksion specifik dhe ku secili brenda saj nxjerr në pah aftësitë që ka. Skuadra duhet të të vendosë në kushtet për të shprehur 110%. Shpesh unë kam sakrifikuar pseudolojtarë, më të aftë se të tjerët sipas opinionit të përgjithshëm, por nuk është kështu. Është shpirti i skuadrës që ka rëndësi, ai të çon më larg. Me skuadrën fiton, me individin fiton një ndeshje me raste.

SULMUESI

Cristiano Ronaldo kërkon largimin, Reali ultimatum: 2 javë afat

Media portugeze trondit tifozët e Realit të Madridit. Cristiano Ronaldo ka kërkuar largimin nga klubi merengues. Është e përditshmja "A Bola" që e publikoi këtë lajm të bujshëm me titullin: Cristiano Ronaldo dëshiron largimin nga Spanja. Sipas kësaj të përditshmeje, 32-vjeçari ua ka komunikuar drejtuesve të Realit të Madridit vendimin e parëvokueshëm të tij. Shkaku kryesor që shtyu luzitanin të ndërmarë këtë hap është hetimi ndaj tij për evazion fiskal. Prokuroria e Madridit e ka paditur sumuesin për fshehje të 14.7 milionë eurove të siguruar nga të drejtat e imazhit për periudhën 2011-2014. Por "A Bola" shkon edhe më tej. Kjo e përditshme këmbëngul se në drejtim të futbollistit kanë ardhur oferta prej 180 milionë eurosh, diçka për të cilën kjo e përditshme kishte folur edhe më parë. Në këtë moment, Manchester United dhe Paris Saint Germain janë të vetmet klube që mund të përballojnë një operacion në merkato që kap vlerën

e 400 milionë eurove në total, ku përfshihen vlera e kartonit të lojtarit dhe paga në skuadrën e tij të re. Reali i Madridit doli në mbështetje publike për Ronaldon ditët e fundit, por kjo duket se nuk ka mjaftuar.

MARCA: 2 JAVË KOHË PËR TË VENDOSUR

Lajmi i mediave portugeze është konfirmuar edhe nga ato spanjolle. E përditshmja "Marca" ka bërë me dije se drejtuesit e Realit e kanë konfirmuar revoltimin e Ronaldos për trajtimin që i kanë bërë organet e rendit. "Më kanë trajtuar si një hajdut ordiner. Do të largohem nga Spanja", duket se u ka thënë ylli portugez drejtuesve të klubit. Duke parë acarimin e Ronaldos drejtuesit e Realit kanë vendosur që t'i japin 2 javë kohë për të qetësuar. Pas 2 javëve CR7 duhet të kthejë një përgjigje përfundimtare nëse do të qëndrojë në Madrid apo do të largohet, në mënyrë që klubi të ketë kohë të bëjë lëvizjet e duhura në merkato.



NË FOTO:
Cristiano Ronaldo

Portieri

Donnarumma, edhe Juventusit futet fuqishëm në lojë

Në Spanjë janë të bindur; e ardhmja e Gigio Donnarummas është tek Reali i Madridit, por mediat sportive italiane raportojnë se Juventusit është vënë në lëvizje fill pas refuzimit të rinovimit të kontratës me Milanin nga ana e portierit 18-vjeçar. Gazzetta Dello Sport shkruan se pak pas këtij lajmi ka patur një takim mes drejtorit sportiv të Juventusit, Beppe Marotta dhe Mino Raiolas, agjentit të Donnarummas. Zyrtarisht u tha se në këtë takim është diskutuar në lidhje me kontratën e Moise Kean, një tjetër talent nën tutelën e Raiolas dhe pjesë e bardhezinjëve, por zërat se në këtë takim është folur edhe për portierin e Milanit i shtoi fakti që Juventusit ka pezulluar thujse në të njëjtën orë negociatat me Arsenalin për portierin Szczesny. Transferi në këtë fazë duket e pamundur, për faktin që nëse do të mbërrinte në Torino, Donnarumma nuk do ta kishte të sigurt vendin e titullarit, pasi Buffon ka edhe një tjetër vit kontratë me bardhezinjtë. Por është edhe opsioni i blerjes nga Juventusit, por i lënies së portierit edhe për këtë sezon si titullar te Milani.



Gigio Donnarummas

FJALËKRYQESH

NGA KADRI VOKOPOLA



FJALËKRYQI PA SKEMË

DUHET TË NXINI 37 KUTI

Large empty crossword grid for the 'Fjalëkryqi pa skemë' section.

HORIZONTAL

- 1. Janë tek në sahan. -Gray i portretit tw Oscar Wilde. -Malet pa kufij. 2. Qe piktori që thirrej Dedo. 3. Imponohet nga epidemitë. -Kufizojn gabimet. 4. Është studio e stilistit. -Është lajm i gëzuar 5. Një sasi në recetë. 6. Emër vajze. -Janë punëtorët e komunistëve. -Japin kredi. 7. Fillojnë mirë. -Bëhen edhe me paralelizma të tilla. -Të parat në start. 8. McKellen aktor -Kush është... e mban kokën lart -Fund takimi -Takat pa ekstreme 9. Është qytet në Greqi. -Një viktimë në corridat 10. Poetica e Horacit. -Një racë kombi. -Bartok që qe kompozitor 11. Kështu blihej pa para në dorë të bakalli. -Një prift. 12. Philippe që që aktor. -Janë peshjtjella.

VERTIKAL

- 1. U themelua nga platon

PËRGJIGJE E FJALËKRYQIT PA SKEMË

Grid of answers for the crossword puzzle, including words like IMAM, KANDAR, ISERE, MIRKIRK, NEDERIK, REKNI, DAMIANOS, FONEMA, METASTASIO, ANAME, FILOKETTID, ANTI, TITO, SALERNO, SI, AD, SERVICE, ITRIO, TI, HORROR, AAA, SA, INTER, INO, STAU, K, KAE, EMAIL, PERSSET, EMM, MARX, VETITE, TOAST, TEMIK, SARI.

- Mbyllin koncertin. 2. Ars... e Ovidit. 3. Dënohej nga Sant' Ufficio një e tillë. -Është edhe ai shiatik. 4. Janë stacionet. -Me të bëjnë setër. 5. Pak enigmatike. -Inicialet e Kline aktor -Mbarojnë fare 6. Një simbol lëkurëkuqsh. -Gjysmë kronik -Kështu përfundojnë ngjarjet. 7. Një stacion i famshëm orbital. -Janë dhëmbët e parë. 8. Titull mafiozi. -Mund të jetë një shkëmb. 9. Është dhomë. -Emri i Gutenberg. 10. Qendër kurimi. -Kështu është kërcimi me stiliin fosbury. 11. Janë në digë. -Sastre aktore. -Kalimi në kufij. 12. Pacino aktor. -Fillon një për të zbuluar krimin. 13. Qendër banimi -Mosketieri jezuit. -Fillojnë pastaj 14. Reforma me tokën. -Ami i Maupassant. 15. Janë të mëdha të tilla me Kubën. -Këndon Skyfall 16. Fund tuneli. -Fillojnë qetësisht -Janë molo... për ndërtim. 17. As unë as ti. -Një kapo kozak

FJALËKRYQI SPORTIV

Crossword grid for 'Fjalëkryqi sportiv' with images of athletes like Cristiano Ronaldo and a tennis player.

PËRGJIGJE E FJALËKRYQIT SPORTIV

Grid of answers for the sports crossword, including names like NDERI, ARJEN, G, OI, SERGE, JBU, K, A, S, I, ARI, TARTARI, EN, ILIR, MARADONA, ALN, A, I, LA, PAN, PA, RAI, LAR, ANO, SAR, EMO, EDINSON, CAVANI, XHERDAN, SHAQIRI.

HORIZONTAL

- 1. Seksion Sigurimi Civil. 4. Gabim pa ekstreme. 7. Kështu fillon sfoda. 9. Fillojnë afrimin. 11. Fitore pa fre. 12. I katërti në kapitull. 13. Ka tetë korsi. 15. Holyfield, ish-kampion i ringut. 18. Panajoti i oaharruar i futbollit. 19. Një është Buffon. 20. Daja trainer. 21. Fantazisti në futbollin amerikan. 24. Nuri, ish kampion i tapetit. 25. Vihet për të dëgjuar.

- 26. Pak personalitet. 27. Një pjesë e akademisë. 28. Luhet në ekstreme. 29. Mbyllin fushat. 31. Ente Lokale Ndërtimi 34. Personazhi në foto. 40. Pak literaturë. 41. Personazhi në foto.

VERTIKAL

- 1. Omar ish as argentinas. 2. Një vend nisjeje. 3. Antonio trainer i Chelsea. 5. Eshë pije... kuqalashë. 6. I katërti në kapitull. 7. Skuadra e Ferrara-s në Itali. 8. Fundi i... garës. 9. Të parat në atletikë. 10. Frashëri ish-mbrojtës bardheblu. 14. Pak sorollatjeje. 15. Është skuadra kampione. 16. Një shtyllë me vela. 17. Ente Ekonomike Berat. 18. Ndahen në barazim. 21. Gjysma e qarkut. 22. Fillojnë udhëtimin. 23. Civile pa zanore 24. Faktet pa fat. 26. Emri i Gascoigne. 27. Murray tenist. 30. Fillojnë matanë. 31. Ente Lokale Rumune. 32. Logaritmi in shkurtër. 33. Tre asa 34. Kufizojnë pushimet. 35. Diftong në duel. 36. Fyes pa fe. 37. Ekstreme në bark. 38. Laçi kur s'është ai. 39. Ekstreme në ambiente

SUDOKU

PLOTËSONI VENDET BOSH NË MËNYRË QË ÇDO RRESHT E KOLONË TË KETË NUMRAT NGA 1-9

9x9 Sudoku grid with some numbers pre-filled.

Another 9x9 Sudoku grid with some numbers pre-filled.

PËRGJIGJE

HOROSKOPI

DASHI

Zemërgjerësia do të shënjojë jetën tuaj në çift. Edhe pse në disa momente mund të keni ndonjë dyshim, kjo nuk do të përbëjë problem. Do të jetë një ditë përgjithësisht e lumtur. Ju beqarë nuk duhet të abuzoni me joshjen sepse nuk do arrini asgjëkundi. Me financat do keni disa probleme. Nga njëra anë do doni të bëni ekonomi por nga ana tjetër do shpenzoni pa masë.

DEMI

Marrëdhënia juaj me partnerin/en do të jetë e zjarrtë dhe nuk mund të qëndroni dot larg-njeri tjetrit. Kjo është normale duke qenë se ndiheni aq mirë bashkë! Për beqarët do jetë një nga ditët më të mira për dashurinë. Jo vetem Venusi, por edhe Jupiteri do ndikojnë në qiellin tuaj dhe do iu sjellin një takim të rëndësishëm. Tregohuni të matur me shpenzimet. matur.

BINJAKËT

Mbase pasion shumë të madh nuk do ketë sot në jetën në çift, po do jeni të lumtur dhe marrëdhënia do jetë e ekuilibruar. Në jetën sentimentale të beqarëve nuk do ndikojë asnjë planet. Për pasojë nuk do ketë ndryshime të mëdha. Nga njëra anë do doni të bëni ekonomi por nga ana tjetër do shpenzoni pa masë.

GAFORRJA

Në planin sentimental të çiftve do ketë ndryshime rrënjësore dhe të gjitha falë pozicionimit të mirë të Jupiterit. Nëse keni fëmijë të rritur ata mund të kenë një surprizë të madhe dhe të bukurojë për ju. Edhe për beqarët do jetë një ditë e mirë, mjafton që të dinë ta shfrytëzojnë! Me kalencat është mirë të tregoheni vigjilentë. Plutoni dhe Jupiteri do ndikojnë negativisht.

LUANI

Jo vetëm që Venusi do të ndikojë në shenjë tuaj, por ai do bashkëpunojë edhe me Jupiterin i cili është planeti më i favorshëm. Të dy do iu premtojnë shumë dashuri. Nëse jeni të martuar do takoni lumturinë dhe pasionin e madh. Nëse jeni vetëm mund të keni takime por nuk duhet të nxitoheni. Disa probleme financiare do të zgjidhen, por kjo nuk do të thotë që ju nuk do kujdeseni më për buxhetin.

VIRGJËRESHA

Ata që janë në çift do jenë pak nostalgjikë sot për ato që kanë kaluar, sidomos ata që kanë moshë më të re. Gjithsesi kjo ditë do jetë e mbushur me tolerancë. Për beqarët, Hëna do të favorizojë takimet pasionante. Pritet të ketë shumë dashuri me shikim të parë! Kujdes me lojrat e fatit sepse nuk është dita e duhur.

PESHORJA

Gjatë ditës së sotme ju dhe partneri/ja, do keni një takim me persona të tjerë. Gjithçka që do ndodhë do iu bëjë të ndryshoni mënyrën e të menduarit dhe të vepruarit në jetën në çift. Beqarët duhet të ruajnë vetëkontrollin sepse situata mund t'iu dalë jashtë kontrollit. Kujdes! Çështjet financiare do jenë të mbrojtura, por kjo nuk iu pengon që të tregoheni më të matur.

AKREPI

Falë Venusit, klima në jetën në çift do jetë e qëndrueshme. Ata që kanë pasur zënka do të pajtohen dhe do e forcojnë lidhjen. Nëse e keni lënë disi pas dore atë që keni në krah bëni ndryshimet e duhura. Jeta seksuale do jetë e mirë. Dielli do ndikojë pozitivisht për beqarët. Do keni aventura. Kujdesuni për financat dhe mos bëni asnjë shpenzim pa u menduar mirë.

SHIGJETARI

Planetët do iu ndihmojnë edhe ju të forconi bashkëpunimin me partnerin/en dhe të ngrohni klimën në çift. Beqarët do tërhiqen tmerrsisht nga dashuritë e pamundura. Kthehuni sa më shpejt në realitet dhe kënaquni me atë që do iu ofrohet! Shumë maturi duhet të tregoni në sektorin e financave. Nëse e menaxhoni me mençuri atë gjithçka do shkojë më së miri.

BRICJAPI

Do kritikoheni ende nga partneri/ja sot për shkak se ai nuk e duron dot rifillimin e deshirës suaj për t'u enduar sa andej këndeje. Nëse mundoheni të flisni me të me takt dhe diplomaci mund të shmangni një perballje të rrezikshme. Beqarët do përfitojnë deri në maksimum nga liria e tyre, por do kenë edhe mundësi për të krijuar një lidhje. Menaxhoni mire financat.

UJORI

Ndikimi i Jupiterit në sektorin e dashurisë do jetë shumë i favorshëm. Nëse jeni në një lidhje do ndiheni të lumtur me atë që keni pranë dhe do përjetoni mjaft kënaqësi së bashku. Dita e beqarëve do jetë e mbrojtur. Ka shumë mundësi që ju të takoni dikë që t'iu bindë të krijoni një lidhje. Kujdes! Beqarët! Nga njëra anë do doni të bëni ekonomi por nga ana tjetër do shpenzoni pa masë.

PESHQIT

Marrëdhënia me partnerin/en do jetë më e mirë nëse ju tregoheni më pak autoritarë. Sigurisht që ju jeni besnikë dhe ndjenjat tuaja janë të sinqerta, por duhet të mundoheni të kerkoni edhe mendimin e atij/asaj kur keni për të marrë vendime. Beqarët, falë Venusit do kalojnë momentet të bukura. Edhe pse do mundoheni t'i organizoni mirë financat nuk do i shmangni dot problemet.

PËRGJIGJE

Grid of answers for the cryptogram section, including words like KARR, OCAT, ET, C, ERIC, L, TRA, U, T, V, TARTARET, U, KAMERIERET, U, DELIRANTET, PR, C, TABOR, AZU, KRIPE, A, BLE, SRO, ILL, STOLI, FISKALE, URR, IZ, R, EKIP, ZE, DATA, AVI, ONET, ET, APA, T, A, VETE.

SHKRONJA E NJËTË PËR NUMËR TË NJËTË

FJALËKRYQI I KRIPTOGRAFUAR

Cryptogram crossword grid with numbers and some letters pre-filled.

NA VIZITONI



BUNK'ART 2

EKSPOZITA VIDEO-MUZEALE BRENDË ISH-BUNKERIT ANTI-BËRTHAMOR I MINISTRISË SË BRENDSHME

www.bunkart.al / info@bunkart.al

**HAPUR ÇDO DITË:
10:00 deri 20:00**



**Prenotime:
+355 (0) 67 20 72 905**

**RR. "ABDI TOPTANI"
PRANË MINISTRISË
SË BRENDSHME-TIRANË**

